



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR**  
**TIRANË**

**Nr.19.Regj.Them.**  
**Datë Rregjistrimi: 02.06.2021**

**Nr.15.VENDIMI**  
**Datë vendimi: 10.06.2021**

**V E N D I M**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur në sallën “Amfiteatri”, në selinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me adresë: Godina Poli i Drejtësisë, Rr. “Ana Komnena”, Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga:

**Gjyqtar: Asim VOKSHI** (*Relator*)  
**Gjyqtare: Edlira PETRI** (*Anëtare*)  
**Gjyqtar: Sokol IBI** (*Anëtar*)  
**Gjyqtare: Alma KOLGJOKA** (*Anëtare*)  
**Gjyqtare: Esmeralda XHILI (ÇEKA)** (*Anëtare*)

me sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, sot më datë 10.06.2021, mbaroi së shqyrtuari në seancë gjyqësore publike, çështjet zgjedhore me nr. 19 akti, datë regjistrimi 02.06.2021 dhe çështjen e bashkuar më të me nr. 21 akti, datë regjistrimi 07.06.2021, që i përket palëve si vijon:

**PADIA E PARË:**

- Paditës:** Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), përfaqësuar me autorizimin nr. 337, datë 03.04.2021, nga Av. Altin Kaziaj.
- I paditur:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar në gjykim me autorizimin nr.5708.prot, datë 10.06.2021 nga Olsi Peto.
- Objekti:** Ndryshimi i vendimit nr. 93, datë 31.05.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

**Baza ligjore:** Nenet 145 e në vijim të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i përditësuar.

PADIA E DYTË:

**Paditës:** Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN), përfaqësuar me autorizim, nga av. Marash Logu.

**I paditur:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar në gjykim me Autorizimin nr. 5708 Prot., datë 10.06.2021 nga Z. Olsi Peto.

**Persona të tretë:** 1) Lëvizja Socialiste për Integrim, përfaqësuar me Autorizimin nr. 337, datë 03.04.2021, nga av. Altin Kaziaj.

2) Partia Socialiste e Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim me autorizimin nr. 180 Prot., datë 27.05.2021 nga av. Maringlen Legisi.

**Objekti:**

1. Kundërshtimi i vendimit nr. 93, datë 31.05.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) për rrëzimin e kërkesës ankimore Nr. 43 të subjektit zgjedhor Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim (PD-AN).
2. Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Korçë.
3. Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Korçë.

**Baza ligjore:** Nenet 1, 18, 35, 42, 45 dhe 64 të Kushtetutës së Shqipërisë. Nenet 6, 8 dhe neni 3, Protokollin 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore. Nenet 136, 137, 145, 152, 153 156, 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor. Nenet 14, 223 dhe 224 të Kodit të Procedurës Civile. Nenet 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Nenet 3 dhe 6 të Vendimit Nr. 9, datë 24.12.2020 të KQZ-së.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, administroi provat në seancë gjyqësore, dëgjoi pretendimet e fundit të palëve, ku pala paditëse, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), kërkoi pranimin e padisë së parë sipas objektit, pala paditëse; Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN), kërkoi pranimin e padisë së dytë sipas objektit; i padituri Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkoi rrëzimin e dy padive të ngritur nga subjektet zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim dhe lënien në fuqi të Vendimit nr. 93, date 31.05.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS); si dhe personi i interesuar, Partia Socialiste e Shqipërisë, kërkoi rrëzimin e plotë të dy padive të ngritur nga subjektet zgjedhore Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN), si të pabazuar në ligj dhe në prova.

## **VËREN:**

### **I. RRETHANA PROCEDURALE:**

1. Se pala paditëse në padinë e parë, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me kërkesëpadi më datë 02.06.2021, duke kërkuar “*Kundërshtimi i vendimit nr. 93, datë 31.05.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS)*”.

2. Pala paditëse në padinë e dytë, Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN), i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me kërkesëpadi më datë 07.06.2021 (nëpërmjet shërbimit postar), duke kërkuar “*Kundërshtimin e vendimit nr.93, datë 31.06.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) për rrëzimin e kërkesës ankimore Nr. 43 të subjektit zgjedhor Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim (PD-AN). Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Korçë. Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Korçë.*”

3. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor në datën 03.06.2021 dhe në datën 07.06.2021 në zbatim të neneve 57, 158/a(ë) të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 154 e 155 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë me vendimin e ndërmjetëm ka vendosur: “*Bashkimin e çështjes së paraqitur më pas me nr. 21.akti, datë regjistrimi 07.06.2021, me paditës Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN), me çështjen zgjedhore të regjistruar më parë e cila mban 19.akti, me datë regjistrimi 02.06.2021 me paditës Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI).*”

### **II. FAKTET E ÇËSHTJES DHE PRETENDIMET E PALËVE:**

4. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, kishte caktuar datën 25 Prill 2021, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

5. Në datën 25.04.2021, në 12 Zonat Zgjedhore në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Zona Zgjedhore Qarku Korçë ka 7 (shtatë) zona të administrimit zgjedhor, përkatësisht ZAZ nr. 69, ZAZ nr. 70, ZAZ nr. 71, ZAZ nr. 72, ZAZ nr. 73, ZAZ nr. 74 dhe ZAZ nr. 75.

6. Me vendimin nr. 346, datë 04.05.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) vendosi miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për subjektet zgjedhore, për zonën zgjedhore Qarku Korçë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021. Në përfundim të procesit të numërimit të votave për subjektet zgjedhore, u konstatuan 123.812 fletë të vlefshme votimi dhe 7.375 fletë të pavlefshme.

Sipas tabelës përmbledhëse rezulton se subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) ka siguruar 8493 fletë të vlefshme votimi, të ndara sipas zonave zgjedhore si vijon:

- ZAZ nr.69, fletë votimi të vlefshme 2718;
- ZAZ nr.70, fletë votimi të vlefshme 1151;
- ZAZ nr. 71, fletë votimi të vlefshme 168;
- ZAZ nr. 72, fletë votimi të vlefshme 1218;
- ZAZ nr. 73, fletë votimi të vlefshme 959;
- ZAZ nr. 74, fletë votimi të vlefshme 1514;
- ZAZ nr. 75, fletë votimi të vlefshme 765;

Sipas tabelës përmbledhëse rezulton se subjekti zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN) ka siguruar 50.479 fletë të vlefshme votimi, të ndara sipas zonave zgjedhore si vijon:

- ZAZ nr.69, fletë votimi të vlefshme 12.509;
- ZAZ nr.70, fletë votimi të vlefshme 9316;
- ZAZ nr. 71, fletë votimi të vlefshme 473;
- ZAZ nr. 72, fletë votimi të vlefshme 7619;
- ZAZ nr. 73, fletë votimi të vlefshme 6228;
- ZAZ nr. 74, fletë votimi të vlefshme 12.035;
- ZAZ nr. 75, fletë votimi të vlefshme 2299;

7. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim administrativ pranë KAS subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), e cila ka pretenduar se:

*- Me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 219, datë 19.04.2021, për vendosjen në karantinë dy javore të shtetasve shqiptarë që vijnë nga Greqia apo Maqedonia e Veriut, në thelb është mohuar e drejta kushtetuese e zgjedhësve shqiptarë me banim në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut për të ushtruar të drejtën e tyre të zgjedhin lirisht për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Vendosja e masave të tilla pak ditë para ditës së votimit dhe heqja e masave pak ditë pas mbarimit të procesit të dëshmon për një vullnet të orientuar politikisht duke penguar shtetasit shqiptarë me banim në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut të ushtrojnë të drejtën kushtetuese të votës. Ky urdhër ka ndikuar drejtpërdrejtë në pjesëmarrjen dhe rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Korçë.*

- Vetëm mbi bazën e njoftimit publik, autoritetet policore, në datën 20 prill 2021 e në vijim, në pikën kufitare me Greqinë, kërkonin prej qytetarëve plotësimin e formularëve për vetëkarantinim, ndërkohë që në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, ende nuk ishte botuar një akt i autoritetit kompetent, me fuqi juridike, përkundrejt pasojave të tij rregulluese/urdhëruese. Ende pa u botuar akti në Fletoren Zyrtare, shtetasve shqiptarë në kufi, që hynin në territorin e Republikës së Shqipërisë, u kërkohej nënshkrimi i një formulari me detyrim, për vetëkarantinimin 14 ditor.

- Pjesëmarrja më e lartë e zgjedhësve (përfshirë zgjedhësit shqiptarë me banim në Greqi) e konstatuar në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin apo Zgjedhjet Vendore, kanë qenë determinante në rezultatin zgjedhor të Subjektit “Lëvizja Socialiste Për Integrim”. Më konkretisht Subjekti “Lëvizja Socialiste Për Integrim” ka arritur të sigurojë një mandat deputeti në zgjedhjet e vitit 2013 dhe në zgjedhjet e vitit 2017, ndërkohë që në zgjedhjet e vitit 2021, nuk ka arritur të sigurojë një mandat deputeti pikërisht nga vendimet e sipërcituara antikushtetuese. Përfundimisht, subjekti ankues LSI kërkon ndryshimin e vendimit nr. 346/2021 të KSHZ dhe shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në Qarkun Korçë.

8. Kundër vendimit nr.346, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) ka paraqitur ankim administrativ edhe subjekti zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN) duke pretenduar se:

- Gjatë periudhës mars-prill 2021, PD ka depozituar 50 kallëzime penale në Prokurorinë e Posaçme SPAK dhe 130 kallëzime në prokuroritë e rretheve, të cilat kanë të bëjnë me vepra penale të tilla si “Shpërdorim detyre”, “Korrupsion aktiv në zgjedhje”, “Përdorim i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, etj.

- Shitblerja e votës është një ndër problematikat kryesore të konstatuara edhe në Deklaratën e Gjetjeve dhe Rekomandimeve Paraprake të Misionit Ndërkombëtar të Vëzhguesve të OSBE/ODIHR, ku konkretisht, në raport thuhet se praktikat gjerësisht të përhapura të shitblerjes së votës vazhduan të përbënin problem.

- Në qarkun e Korçës janë konstatuar raste të blerjes së votës duke shpërndarë dhurata për kategori njerëzish me qëllime elektorale, duke dhënë kredi me kushte lehtësuese nga Buxheti i Bashkisë, duke caktuar dhënie e një shpërblimi fund viti për mjekët dhe punonjësit e Policisë së Shtetit, duke ndryshuar strukturën dhe nivelin e pagave për punonjësit e stafit mjekësor, punonjësit e tjerë me arsim të lartë, etj.

- Janë përdorur në mënyrë të paligjshme burimet shtetërore për devijimin e vullnetit të zgjedhësve.

- Nëpunësit civilë ishin nën presion të vazhdueshëm për të mbështetur kandidatët socialistë, në të kundërt mund të shkarkoheshin nga detyra. Presionet ndaj nëpunësve publikë dhe detyrimi i tyre për t’u angazhuar në fushatë u evidentuan edhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR, ku konkretisht shprehen se ofrimi i stimujve dhe presioni i pretenduar ndaj nëpunësve civilë përbënin problem.

- Nga viti 2017 e në vijim, Qeveria ka nxjerrë 28 vendime duke shtuar numrin e punësimeve në strukturat e qeverisjes qendrore me 16645 pozicione të reja, për përfitim politik, duke devijuar vullnetin.

- Në datën kur ka nisur fushata zgjedhore, më 25 mars 2021, Këshilli Bashkiak i Bashkisë së Korçës ka miratuar Vendimin nr. 30, datë 25.03.2021 “Për miratimin e diferencës së kontributit financiar të Bashkisë Korçë për vitin 2021 “Për projektin për përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”, i cili në thelb transferon një shumë prej 243,203 Lekësh nga programi Arsimi bazë dhe parashkollor dhe e kalon këtë shumë në programin e strehimit social.

- Sipas Ministrisë së Financave, për periudhën janar-prill 2021 janë paguar 20 milionë euro më shumë për paga krahasuar me në njëjtën periudhë të vitit 2020.

- Me qëllim ndikimi në shtresat vulnerabël, bazuar në të dhënat zyrtare të Ministrisë së Financave, qeveria ka paguar për ndihmën ekonomike për familjet në nevojë 313,763,706 lekë më shumë për periudhën janar-prill 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

- Deputetë të ndryshëm të Partisë Socialiste kanë shpërndarë leje legalizimi në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe Vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së.

- Në datën 11 prill, media publikoi një bazë të dhënash të 910.000 zgjedhësve që përdorte Partia Socialiste në Tiranë, duke bërë publike të dhëna personale si numri i ID, vendi i banimit, numri i telefonit dhe bindja politike e shprehur në zgjedhjet e kaluara dhe projeksionet për zgjedhjet e 2021. Këto të dhëna janë marrë nga të dhëna shtetërore që qytetarët i kanë vënë në dispozicion në portalin e-albania për të marrë shërbime gjatë pandemisë, apo në institucione të tjera shtetërore për të marrë shërbime nga administrata.

- Në 17 prill 2021, Kryeministri Edi Rama gjatë një takimi elektoral në qytetin e Durrësit, falenderoi patronazhistët për punën e bërë. Fakti që vetë Kryeministri e pranoi këtë fenomen dhe e normalizoi atë përmes falenderimeve, tregon se databaza të njëjta me ato të publikuara kanë ekzistuar në të gjithë Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë edhe Korçën. Skandali me të dhënat personale u evidentua edhe në Raportin paraprak të OSBE/ODIHR.

- Komiteti Teknik i Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë, vetëm 1 javë para zgjedhjeve, nxori një vendim që detyronte emigrantët që vinin nga Greqia apo Maqedonia e Veriut të karantinoheshin detyrimisht për një periudhë 2-javore. Ky vendim pengonte efektivisht mbi 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës, në mënyrë diskriminuuese.

- Zgjedhësit që ishin infektuar me COVID-19 dhe që ndodheshin në karantinë, qenë të detyruar të respektonin rregullat e izolimit, duke çuar de fakto në mohimin e të drejtës së tyre për të votuar. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, numri i personave të infektuar në ditën e zgjedhjeve ishte 23.000. Kjo praktikë bie ndesh me dispozitat për të drejtat e votimit dhe

barazinë e votës të parashikuar në nenin 45 të Kushtetutës dhe në paragrafin 7.2 të Dokumentit të Kopenhagenit.

- Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor nga Partia Socialiste, duke shkelur marrëveshjen konsensuale me KQZ-në, u evidentuan si problematikë edhe nga Misioni i OSBE/ODIHR. Në opinionin e tyre të përbashkët, Komisioni i Venecias të Këshillit të Evropës dhe ODIHR-i shprehën keqardhje që procedurat e miratimit të ndryshimeve në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor kishin qenë jashtëzakonisht të nxituara dhe që nuk ishin paraprirë nga një proces i duhur konsultimi.

- Numri i votave të pavlefshme ishte 83.026, ose 5% e numrit total të votuesve dhe ky fakt është ndikuar nga përmbajtja e fletës së votimit me numra dhe jo me emrat e kandidatëve, duke krijuar konfuzion ditën e zgjedhjeve.

- Ligji diskriminon kandidatët gjatë procesit zgjedhor, duke u lejuar vetëm kryetarëve të partive, por asnjë kandidat tjetër, që të kandidojnë deri në katër zona zgjedhore, ndërkohë që kandidatët e tjerë mund të kandidojnë vetëm në një zonë, gjë që përbën shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta.

- Përfundimisht, PD kërkon pranimin e ankimit për kundërshtimin e Vendimit nr. 346, datë 04.05.2021 “Për Miratimin e Tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore qarku Korçë për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

9. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) pranë KQZ me vendimin nr.93, datë 31.05.2021 ka vendosur:

“1. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 43, datë 09.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD - AN).

2. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 48, datë 09.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

3. Lënien në fuqi të vendimit nr. Nr. 346, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore qarku Korçë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.”

10. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ndër të tjera ka arsyetuar si vijon:

10.1. Në lidhje me kërkimin e ankuesve për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në këtë qark, është argumentuar:

Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e tyre dëmprurëse mbi zgjedhjet. Në këto raste dëmi mund të vijë edhe nga një shkelje e vetme, por tronditëse për

zgjedhësit ose rregullshmërinë e procesit (p.sh. cënimi i integritetit të kutive të votimit - nenet 115 dhe 138 të KZ). Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen “shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor”. Shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur. Votimi familjar p.sh. që është konstatuar shpesh nga misionet vëzhguese të OSBE/ODIHR-it si shkelje e procesit zgjedhor nuk është konsideruar nga ata kurrë si shkelje që shkakton pavlefshmërinë e zgjedhjeve, sepse ata nuk e kanë vëzhguar asnjëherë këtë shkelje në masën e vet kritike. Po kështu, shitblerja e votës që gjithashtu është kritikuar në një numër zgjedhjesh dhe që këtë herë u cilësua si “problem i përhapur”, nuk u vëzhgua prej tyre në masë kritike....

Kodi Zgjedhor ka përpunuar mjete ligjore të ndryshme për shkelje të ndryshme. Për një pjesë prej tyre mjeti ligjor është gjoba administrative (shkeljet e kryera nga media, subjektet zgjedhore, përfaqësuesit e institucioneve), për një pjesë janë masat disiplinore (shkarkimi etj.), për një pjesë është ndjekja penale (shitblerja e votës, shpërdorimi i detyrës, korrupsioni aktiv dhe pasiv në zgjedhje etj.), por për asnjërën prej tyre Kodi nuk ka përcaktuar si mjet ligjor pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Kjo është arsyeja pse ekzistenca e një apo më shumë shkeljeve, qofshin këto edhe të rënda, nuk është shkak i vetëmjaftueshëm për të kërkuar pavlefshmëri. Kjo është arsyeja pse kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik që vërteton se shkelja e pretenduar është “shkelje që çënon rëndë procesin zgjedhor”, sikurse duhet të shoqërohen edhe me provën se sa dhe si e ka cënuar ajo procesin zgjedhor.

#### 10.2. Në lidhje me provat e tjera KAS ka analizuar se:

Nga pohimet e avokatit të subjektit ankues PD rezulton se provat e paraqitura prej këtij subjekti ankues dhe të pranuarat për shqyrtim nga KAS-i nuk faktojnë sa raste shitblerje vote, sa raste lejesh legalizimi, sa raste punësimi, sa raste mohimi të së drejtës për votim për emigrantët, sa raste votimi të shumëfishtë ka pasur në qarkun e Korçës. Po kështu, ato nuk faktojnë se sa secili prej këtyre fenomeneve, apo edhe i formave të tjera të përdorimit të burimeve shtetërore, i dhënies së ndihmave apo i ushtrimit të presionit mbi zgjedhësit kanë ndikuar në pengimin/largimin e zgjedhësve nga votimi, në detyrimin e votuesve që të votojnë në një mënyrë të caktuar, apo tjetërsimin e votës. .... Pavarësisht nga ky fakt, subjekti ankues nuk kishte bërë asnjë përpjekje për sigurimin e tyre, por kërkoi që KQZ-ja t'i merrte ato. Subjekti ankues nuk ishte në gjendje të identifikonte nëse ekzistonin dokumente pranë këtyre institucioneve që të përmbanin informacionin e kërkuar. Ai pohoi në



*seancë se nuk kishte disponuar mbi të dhëna nga informacionet e kërkuar në momentin e hartimit të kërkesës ankimore, por besonte se, nëse merreshin si prova, ato do të konfirmonin pretendimet e ankuesit.*

*Subjekti ankues ka depozituar si prova në mbështetje të pretendimeve të veta 3 (tre) kallëzime penale. Kallëzimet penale të depozituara si prova nuk provojnë në asnjë rast ekzistencën apo vërtetësinë e fakteve apo ngjarjeve të përshkruara në të. Ai provojnë vetëm faktin se PD për zonën zgjedhore Qarku Korçë ka depozituar së paku tre kallëzime penale.*

*Kodi Zgjedhor përcakton në pikën 4 të nenit 91: “4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore”. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1076, datë 24.12.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e ministrisë së shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura”, të ndryshuar” ka dalë brenda periudhës së ndalimit dhe sjell rritje pagash për kategori të caktuara punonjësish publikë. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1044, datë 18.12.2020 “Për një shtesë në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar” është miratuar përpara fillimit të periudhës së ndalimit, prandaj nuk përbën shkelje, sikurse miratimi i vendimit nr. 1102, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2021” nuk përbën shkelje, sepse ai është vendim procedurash dhe kriteresh lidhur me një fond që është dhënë me ligjin për buxhetin e vitit 2021. Shkelja e kryer në favor të subjektit zgjedhor PS me nxjerrjen e VKM nr. 1076, datë 24.12.2020 formon kundërvajtje administrative sipas nenit 172 të Kodit Zgjedhor. Nga pohimet e përfaqësuesve administratës së KQZ-së rezulton se PD nuk ka bërë ankim në KQZ për këtë shkelje. Në të njëjtën kategori bën pjesë dhe pretendimi i subjektit ankues PD lidhur me Vendimin nr. 30, datë 25.03.2021 “Për miratimin e diferencës së kontributit financiar të Bashkisë Korçë për vitin 2021 “Për projektin për përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara” të Këshillit Bashkiak*

Korçë. KAS konstaton se në këtë rast kemi të bëjmë me një kontribut për një projekt që ka ekzistuar si i tillë përpara datës 24.12.2021. Pra, fondet kanë qenë të parashikuara më parë, dhe vetëm janë rialokuar me qëllim për të plotësuar kontributin në fjalë. Për këtë arsye, ky vendim nuk bën pjesë në kategorinë e vendimeve të pikës 4 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

Një grup provash të depozituara nga subjekti ankues ilustronë debatin mediatik rreth të ashtuquajturit “skandali i patronazhistëve”, i cili ka lidhje me një bazë të dhënash prej rreth 900 mijë zgjedhësish, ku ishin fiksuar, ndër të tjera, dhe preferencat e aluduara politike të tyre. Nga tërësia e të dhënave të bazës janë me interes për zgjedhjet të dhënat për preferencat politike. Këto të dhëna janë dukshëm produkt i punës së “patronazhistëve”, mbështetur në “eksplorimin” e tregut politik nga strukturat partiake. Kjo metodë eksplorimi politik bën pjesë në taktikat tradicionale të partive politike, ndonëse metodat ndryshojnë nga njëra parti në tjetrën. Pjesa tjetër e të dhënave janë të dhëna personale, që janë siguruar në mënyrë të paqartë, përveç listës me emra zgjedhësish e cila është publike dhe u ofrohet partive politike në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor (pika 2 e nenit 60). Përdorimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale rregullohet nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale. Rrethanat e lidhura me skandalin e patronazhistëve provojnë shkallën e ulët të respektimit të rregullave të vendosura nga ky ligj në Shqipëri. Provat e paraqitura në këtë kontekst provojnë sensibilitetin ndaj ngjarjes, por jo ndikimin e saj tek votuesit. Subjekti ankues nuk solli prova se publikimi mund të kishte intimiduar zgjedhësit dhe t’i kishte mbajtur ata larg nga procesi i votimit. Pjesëmarrja në këto zgjedhje në zonën zgjedhore Qarku Korçë ishte 131198 (46,13%), nga 132463 (47,23%) që ka qenë në vitin 2017. Në ditën e votimit misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR-it vuri re në disa qarqe “grupe të rinjsh që grumbulloheshin jashtë qendrave të votimit dhe dukej se kontrollonin zonën dhe mbanin shënim se kush votonte”. Edhe kjo formë patronazhi është pjesë e taktikave elektorale të partive të mëdha, pjesë e metodave që kompletojnë bazat e të dhënave të partive politike. Për këtë u servir si provë një pjesë nga raporti i ODHIR (fq. 19).

Kodi Zgjedhor ka parashikuar mundësinë për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë shtetit që të votojnë në zgjedhjet për Kuvendin. Komisionit Rregullator i është lënë kompetenca e posaçme që të vendosë “zhvillimin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit, mbështetur në raportimin e Komisionerit për plotësimin e masave tekniko-organizative që mundësojnë votimin” (shkronja “ç” e pikës 2 të nenit 20). Në zgjedhjet e 25 prillit 2021 Komisioni Rregullator nuk e shfrytëzoi këtë kompetencë, duke mos e ligjëruar mundësinë e kësaj kategorie zgjedhësish të votonin në distancë. Në këto zgjedhje mund t’a shfrytëzonin këtë mundësi, nëse do bëhej e aplikueshme,

vetëm 3613 zgjedhës nga 4572 shtetas të regjistruar me banim jashtë shtetit (të dhënat janë marrë nga KQZ-ja). Për shkak të mosaplikimit të votimit nga jashtë vendit, e drejta e tyre e votimit do të realizohet në këto zgjedhjeve vetëm nëpërmjet paraqitjes në qendrën e tyre të votimit. Ky modalitet votimi është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Pamundësia e votimit në distancë në këto zgjedhje për shtetasit shqiptarë me banim jashtë shtetit nuk formon shkelje. Atje ku nuk ka shkelje nuk ka pavlefshmëri.

Subjekti ankues ngriti pretendim kundrejt urdhrit nr.219, datë 19.04.2021 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia" si një "vendim që pengoi efektivisht 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës". Urdhri i sipërcituar është motivuar me nevojën për të dominuar përhapjen e epidemisë Covid-19, në kushtet e "kontakteve më intensive në popullatë deri në përfundim të festës dhe veprimtarive fetare të lidhura me pashkët ortodokse". Vetizolimi i personave që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë është një masë që është marrë në mënyrë të përsëritur që nga koha e nisjes së pandemisë dhe ka qenë e lidhur me statistikën e sëmundshmërisë dhe pritshmëritë nga ngjarje të caktuara. Mbyllja, izolimi apo vetizolimi kanë qenë masa dominuese edhe në rastet e festave të tjera zyrtare, publike ose fetare. Në kohën që u mor kjo masë Republika e Greqisë ka pasur në fuqi izolimin 14 ditor dhe numrin e kufizuar të hyrjeve për personat që hynin në territorin grek nga Shqipëria. Më vonë kjo masë u shndërrua në izolim 7 ditor. Shqipëria e mbajti në këmbë këtë masë deri më datën 3 maj 2021, d.m.th. deri pas festës. Urdhri nr.219, datë 19.04.2021 është kontestuar pa sukses në rrugë ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit nga subjekti ankues LSI. Subjekti ankues PD nuk ka shfrytëzuar mjetet ligjore për kontestimin e tij. Për këtë arsye, ligjshmëria e urdhrit nuk mund të vihet në diskutim. Efektet e një urdhri të ligjshëm nuk mund të formojnë shkelje. Pa shkelje nuk ka pavlefshmëri.

Subjekti ankues PD-AN ka referuar se në ditën e zgjedhjeve kanë qenë 23.000 persona të infektuar me Covid-19, sipas të dhënave zyrtare nga Ministria e Shëndetësisë. Statistika e ofruar nuk saktëson se sa prej tyre kanë qenë zgjedhës për zonën zgjedhore qarku Korçë. Për zgjedhësit e kësaj kategorie nuk ka qenë e mundur të votonin në kushtet e izolimit. Deklarata e Misionit vëzhgues të OSBE-ODIHR-it e ka quajtur këtë "mohim de facto i të drejtës për të votuar" (faqe 7). Kodi Zgjedhor nuk parashikon mundësinë e votimit në distancë për zgjedhësit me vendbanim në Republikën e Shqipërisë, sikurse nuk autorizon KQZ-në që të përpunojë rregulla dhe të marrë masa për kryerjen e një votimi të tillë. Ky është kuadri ligjor për zgjedhjet. Kushtetueshmëria e tij nuk është sfiduar në

rrugë ligjore. Edhe kushtetueshmëria e rregullave të izolimit për shkak të pandemisë Covid-19 nuk është sfiduar në rrugë ligjore. Kjo është arsyeja që Misioni vëzhgues e quan rezultatin mohim de facto, por nuk e quan shkelje. tje ku nuk ka shkelje nuk ka pavlefshmëri. Një pretendim i veçantë ka lidhje me numrin anomalisht të lartë të fletëve të votimit të pavlefshme. Në zonën zgjedhore Qarku Korçë numri i këtyre votave është 7375 ose 5.62% e numrit total të votave, por ky numër nuk mund të konsiderohet anomalisht i lartë, sepse mungon baza krahasuese. Pas ndryshimeve të fundit të Kodit Zgjedhor, votuesve iu dha mundësia të ushtronin të drejtën e tyre, duke hedhur dy vota, një për subjektet dhe një tjetër për kandidatët. Statistika nuk mund të krahasohet me votimet e kryera në Shqipëri, kur zgjedhësit kanë hedhur vetëm një votë. Në vlerësimin e subjektit ankues pavlefshmëria e lartë lidhet me kompozimin e fletës së votimit, gjë që përforcohet edhe nga deklarata e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve e datës 28.04.2021. Subjekti ankues nuk paraqiti asnjë fakt që të provonte lidhjen shkakësore midis vendimit të Kolegjit Zgjedhor për përmbajtjen e fletës së votimit dhe numrit të lartë të fletëve të pavlefshme. Deklarata e Komisionerit nuk e nxjerr këtë lidhje. Nga ana tjetër, ka një grup shkaqesh, të cilat duhet të mbahen në konsideratë gjatë analizës faktike rreth kësaj çështjeje si p.sh. fakti se në këto zgjedhje u votua me dy vota dhe probabiliteti i gabimit dyfishohet, fakti se fushata edukuese nuk pati efektin e dëshiruar ose nuk e davariti dot konfuzionin, fakti se kandidatët nuk harmonizuan dot mënyrën e re të votimit me taktikat elektorale, apo fakti se pavlefshmëria mund të ishte mënyrë votimi me dashje nuk mund të eliminohen vetëm për shkak se nuk përputhen me linjën e arsytimit të ankuesit. Misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR-it identifikon si shkak të mundshëm vonesën në nisjen e fushatës informuese-edukuese. Pavlefshmëria e votës është pjesë e rregullave të votimit dhe numërimit të votave, nuk është mohim i së drejtës për të votuar (nuk ka mohim të së drejtës kur e drejta është ushtruar), nuk është shkelje e Kodit Zgjedhor, për pasojë nuk formon shkak për pavlefshmëri të zgjedhjeve.

Subjekti ankues PD ka përfshirë në ankim një numër provash që bëjnë fjalë për individë të aluduar me rekorde të tmerrshme kriminale, të cilët janë të lidhur me interesa biznesi me shumicën qeverisëse dhe që janë përfshirë “si eksponentë që kontribuonin në këtë fushatë edhe për shkak të përfitimeve që kanë marrë nga PS”. Faktet e referuara në provat e depozituara dhe në shtjellimin e kërkesës ankimore nuk krijojnë lidhje faktike dhe logjike me shkelje të Kodit Zgjedhor dhe nuk provojnë kërkesën për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve.

Subjekti ankues PD u tërhoq nga pretendimi i tij i shprehur në pikat 52-54 të kërkesës ankimore dhe e zëvendësoi atë me pretendimet që rezultuan nga administrimi i rezultateve të kryqëzimit të të dhënave nga pajisjet PEI të përdorura për identifikimin e votuesve. Subjektet

ankuese në tërësi pretenduan se materiali shpjegues me statistikën e kontrollit të kryqëzuar të të dhënave PEI dhe dëshmia e Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve provojnë se ka patur parregullsi në administrimin e pajisjeve, të cilat kanë lidhje me regjistrimin e një gjurme daktiloskopike për më shumë se një identitet zgjedhësi, sikurse ka pasur raste të izoluara të personave me identitet dhe gjurmë daktiloskopike të njëjtë në dy qendra votimi të ndryshme. Në vlerësimin e përfaqësuesit të subjektit ankues PD ky fakt provon se ekziston mundësia që një person i vetëm të ketë votuar në emër të shumë zgjedhësve dhe kjo e bën votimin në këto raste të pavlefshëm. Nga shqyrtimi i materialit të servirur nga KQZ-ja rezulton se ai jep informacion për fazën e parë të hetimit administrativ që neni 167/2 i KZ kërkon të kryhet “pasi të jetë shpallur rezultati përfundimtar, të jenë përmbyllur procedurat ankimore dhe zgjedhjet të kenë përfunduar” me qëllimin “për të verifikuar rregullsinë dhe saktësinë e veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit dhe vlerësimin e numërimit të votave”. Rezultatet e servirura në material formojnë indicie për hetimin administrativ të KQZ-së, por nuk formojnë dot prova për të mbështetur pretendimin e subjektit ankuese “për raste të shumta të votimit të dyfishtë”. Materiali i servirur konstaton se për zonën zgjedhore ka një listë prej 63 rastesh të identifikuar me gjurmë daktiloskopike të dyshuara të njëjta nga pajisjet, por jo të përputhshme. Nëse gjurmët do ishin të përputhshme, atëherë pajisja do t'i kish deklaruar të përputhshme ato. Vetëm në dy raste ky dyshim përjas gjurmën daktiloskopike me identitetin e njëjtë në dy qendra votimit të ndryshme. Mbi bazën e informacionit të përftuar nga materiali i servirur mund të ngrihen vetëm hipoteza për sjelljen e zgjedhësve të evidentuar por nuk mund të krijohet bindja për shkelje të provuara, aq më tepër për votim të dyfishtë. Nga palët në proces u argumentua se materiali i servirur provon se administrimi i procesit nga operatorët ka qenë i parregullt. KAS-i çmon se ky pretendim nuk ka lidhje me pretendimin për votim të shumëfishtë për të cilin ishte kërkuar marrja e provës. Ky material dhe stadi aktual i hetimit administrativ të KQZ-së nuk e provon pretendimin për votim të shumëfishtë.

Subjekti ankues PD e ka mbështetur kërkesën e vet për pavlefshmëri edhe në deklaratën e Misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR-it për gjetjet dhe konkluzionet paraprake, të datës 26.04.2021. Dokumenti përmban gjetje dhe të dhëna për shitblerjen e votës dhe për përdorimin e burimeve shtetërore, të cilat janë referuar në kërkesën ankimore. Në vlerësimin e këtij dokumenti KAS-i duhet të ndajë referencat me burim interlokutorët nga referencat me burim vëzhguesit e misionit. Në vlerësimin e tij të përgjithshëm misioni vëzhgues ka konstatuar se edhe në këto zgjedhje “mbetën problem praktikë gjerësisht të përhapura të blerjes së votës” (faqe 2), sikurse ka konsideruar të besueshme

*“raportimet sipas të cilave koordinatorët e partive të mëdha u ishin afruar për t’u blerë votat një numri domethënës votuesish nga komunitetet rome dhe egjiptiane (faqe 16). Deklarata eidenton faktin se “ministrat vijuan fushatën përgjatë veprimtarive zyrtare dhe me këtë publicitet i dhanë përparësi domethënëse partisë qeverisëse”, sikurse thekson se ishin shqetësim dhënia e incentivave dhe pretendimet për presion mbi nëpunësit publikë (faqe 2). Dokumenti nuk përmban të dhëna specifike në lidhje me Qarkun Korçë në këto aspekte. Gjetjet dhe konkluzionet paraprake të deklaratës janë të besueshme dhe të pranueshme. Sipas gjetjeve dhe konkluzioneve të kësaj deklarate të ODIHR, ka përhapje të fenomenit, blerja e votave është e pranishme si metodë së paku tek partitë e mëdha. Gjithsesi, përmasat e këtyre fenomeneve nuk formojnë, në gjykimin e misionit vëzhgues, shkak për pavlefshmëri, përndryshe deklarata nuk do t’i konsideronte zgjedhjet si zgjedhje ku “votuesit mund të zgjidhnin midis kandidatësh, të cilët mund të bënin lirshëm fushatë, me një kuadër ligjor që respekton liritë themelore” dhe ku “zgjedhjet ishin në përgjithësi të mirëorganizuara”(faqe 1).*

*Subjekti ankues PD kërkoi nga KAS-i që të merrte në cilësinë e provës 19 informacione specifike nga institucione të ndryshme që veprojnë në territor. KAS-i, pasi shqyrtoi kërkesën vendosi me shumicë votash rrëzimin e saj.*

### 10.3. Përfundimisht KAS ka vlerësua se:

*“1. Shqyrtimi administrativ eidentoi raste shkeljesh të detyrimeve ligjore, të cilat formojnë kundërvajtje administrative. Shkeljet e eidentuara nuk provohet të kenë pasur ndikim në pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim, në ushtrimin e lirë dhe të pandikuar të së drejtës së tyre apo në tjetërsimin e vullnetit. Ato nuk formojnë “shkelje që cenojnë rëndë procesin zgjedhor” dhe as “shkelje që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore”, për pasojë nuk mund të shërbejnë si shkak për të shpallur zgjedhjet të pavlefshme në një ose më shumë qendra votimi.*

*Çdo ngjarje, fakt apo situatë e zhvilluar në zbatim apo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi nuk formon shkelje dhe nuk mund të shërbejë si shkak për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimit.*

*Çdo shkelje e pretenduar dhe që nuk mund të provohet se ka ndodhur ose se ka pasur ndikim mbi zgjedhjet në formën e pengimit të zgjedhësve për të marrë pjesë në votim, detyrimin të tyre për të votuar në një mënyrë të caktuar apo në formën e tjetërsimit të votës nuk mund të shërbejë si shkak për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimit.”.*

11. Subjekti politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN) dhe pasi janë bërë me dije me vendimin e K.A.S. duke pretenduar se ky vendim është i

pabazuar në ligj dhe në prova i janë drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me paditë objekt gjykimi.

12. Pala paditëse, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), në kërkesë padinë e parë dhe gjatë gjykimit, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, pretendoi se:

- Vendimi objekt ankimi nr. 93, datë 31.05.2021 është i pabazuar në ligj dhe në prova në lidhje me shqyrtimin dhe rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 43, datë 09.06.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim.
- Me urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 219, datë 19.04.2021, për vendosjen në karantinë 2-javore të shtetasve shqiptarë që vijnë nga Greqia apo Maqedonia e Veriut, në thelb u është mohuar e drejta kushtetuese e zgjedhësve shqiptarë me banim në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut, për të ushtruar të drejtën e tyre të zgjedhin lirisht për zgjedhjet e 25 Prillit 2021. Pikërisht kjo masë e propozuar dhe e marrë 4 ditë para ditës së zgjedhjeve, provoi se vendimmarrja e propozuar e Komitetit Teknik të Eksperteve dhe akti miratues i Ministrit të Shëndetësisë, ishin akte të formësuar nga një vullnet jo objektiv, por i orientuar politikisht, që solli si pasoja direkte negative pengimin e këtyre qytetarëve për ushtrimin e së drejtës së votës.
- Procesi i votimeve në Qarkun Korçë ka qenë i cënuar në thelb, pasi është cënuar e drejta kushtetuese e votuesve shqiptarë me banim në Greqi dhe në Maqedoninë e Veriut, të cilët kanë qenë të regjistruar në listën e zgjedhësve të qarkut Korçë, dhe janë penguar në ushtrimin e të drejtës kushtetuese të votës, e drejtë e sanksionuar në nenet 3, 17 dhe 45 të Kushtetutës së Shqipërisë.
- Urdhri i sipërcituar është një akt normativ i cili sipas nenit 177/1 të Kushtetutës, merr fuqi juridike vetëm pas botohet në Fletoren Zyrtare të RSH, Botimi në fletoren zyrtare është kryer në datën 21.04.2021. Ndërkohe ky urdhër është zbatuar faktikisht nga data 20.04.2021, pasi në pikat kufitare, shtetasit ishin të detyruar të plotësonin formularin e vetëkarantinimit. Autoritetet shtetërore, Ministria e Shëndetësisë nuk morri asnjë iniciative për ndryshimin e këtij qëndrimi edhe pse një masë e tillë shtrënguese është apeluar nga shoqatat e emigrantëve, gjithë partitë politike garuese si dhe nga përfaqësuesit ndërkombëtarë.
- Avokati i Popullit, me shkresën Nr. 222 Prot, datë 21.04.2021, ka dërguar rekomandime, për anulimin tërësisht e të menjëhershëm të Urdhrit nr. 219, datë 19.04.2021, ndaj Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komitetit Teknik.
- Në vijim të këtij arsyetimi, edhe vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Nr. 346, datë 04.05.2021 të KSHZ, “Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Korçë”, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill

2021”, është i paligjshëm dhe duhet të priset pasi ndodhemi në kushtet e parashikuara në nenin 160, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

- Analiza e fakteve dhe provave të depozituara pranë KAS në cilësinë e provave materiale është bërë jo në përputhje me parimet e përgjithshme të vlerësimit të provave, në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor, Kodit të Procedurës Civile si dhe Kodit të Procedurës Administrative.
- Mos marrja në konsideratë e tregueseve objektiv statistikor dhe provave të pa kundërshtueshme të vënë në dispozicion gjatë hetimit administrativ është fakt dhe provon katërcipërisht se vendimi nuk është i bazuar mbi vlerësimin objektiv të provave dhe rrethanave të cilat provojnë shkeljet e ligjit në këtë qark. Ky vendim është bazuar vetëm mbi urdhra politik duke shpërdoruar dhe shkelur dispozitat eksplicite ligjore të cilat normojnë paligjshmërinë në procesin elektorale.
- Përfundimisht, subjekti zgjedhor LSI, kërkon ndryshimin e vendimit të KQZ/KAS nr. 93, datë 31.05.2021, shpalljen e pavlefshmërisë ligjore të rezultateve të Qarkut Korçë dhe urdhërimit e përsëritjeve të zgjedhjeve, pasi ajo disponon të gjitha provat, që mbështesin këtë kërkim.

13. Pala paditëse, Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN), në kërkesëpadi dhe gjatë gjykimit, nëpërmjet përfaqësuesve të saj, pretendoi se:

- Vendimi i KAS është i cënueshëm, ai është marrë në shkelje të ligjit procedural dhe ligjit material, si dhe nuk është kryer një hetim i plotë e i gjithanshëm.
- Në lidhje me ligjin procedural: Subjekti zgjedhor PD – AN gjatë hetimit administrativ ka vendosur në dispozicion të KAS çdo provë të siguruar nga vetë ajo, më qëllim identifikimin e të gjitha aspekteve të paligjshmërisë që karakterizuan procesin zgjedhor të 25 prillit.
- Në kushtet kur një pjesë e provave ka qenë e pamundur të sigurohet nga subjekti, ky i fundit i ka kërkuar KAS-ti që ti drejtohet organeve të administratës shtetërore, për të vënë në dispozicion informacione, dokumente dhe çdo provë tjetër që kërkohet ose çmohet e nevojshme për hetimin administrativ.
- Kërkesa e subjektit është refuzuar nga KAS, kjo në shkelje flagrante të nenit 136, pika 1, shkronja “c” dhe nenit 137 të Kodit Zgjedhor.
- Në lidhje me themelin e pretendimeve për pavlefshmëri:
- Në lidhje me pavlefshmërinë e zgjedhjeve: Kodi Zgjedhor ka përcaktuar në mënyrë të detajuar cilat janë rastet kur zgjedhjet shpallen të pavlefshme, cili është organi kompetent dhe pasojat që sjell një vendim i tillë, sipas përcaktimeve të nenit 160 të Kodit Zgjedhor. Ndërsa në rast të marrjes së një vendimi për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një zonë zgjedhore, neni 161, pika 1 parashikon se KQZ-ja, eventualisht Kolegji Zgjedhor urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore.



- Në rastin konkret, subjekti zgjedhor PD-AN ka parashtruar një numër të madh shkeljesh të Kushtetutës, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kodit të Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore dhe Kodit Zgjedhor, të cilat në tërësinë e tyre cënojnë rëndë procesin zgjedhor në një masë të tillë që ndikojnë drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Tërësia e këtyre shkeljeve krijon bindjen e plotë bazuar në fakte dhe prova të pakundërshtueshme, si dhe Kodin Zgjedhor, për shpalljen e pavlefshme dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore Korçë.
- Mohimi i të drejtës për të votuar i emigrantëve: Deri në datën 19 prill 2021, nuk ka pasur asnjë ndalim që emigrantët shqiptarë, të hynin në Shqipëri dhe të vendoseshin në karantinë. Komiteti Teknik i Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë, vetëm 1 javë para zgjedhjeve, nxori një vendim që detyronte emigrantët që vinin nga Greqia apo Maqedonia e Veriut të karantinoheshin detyrimisht për një periudhë 2-javore. Ky vendim pengonte efektivisht 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi dhe Maqedoni, për të ushtruar të drejtën e votës, në mënyrë diskriminuese.
- Zgjedhësit, që ishin të infektuar me COVID-19 dhe që ndodheshin në karantinë, qenë të detyruar të respektonin rregullat e izolimit, duke u cënuar de facto e drejta e tyre për të votuar.
- E drejta e çdo qytetari shqiptar për të votuar është e sanksionuar në nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, njëkohësisht është një nga të drejtat themelore e parashikuar në nenin 3, Protokollin 1 të KEDNj.
- Ndërsa në neni 24 dhe 25 të Kodit Zgjedhor, është parashikuar shprehimisht e drejtën e votimit për emigrantët shqiptar në vendin e tyre të rezidencës, mundësi kjo e cila nuk u është dhënë, duke mohuar një nga të drejtat e tyre themelore.
- Blerja e votës dhe përdorimi i personave me rekorde të tmerrshme kriminale: Në qarkun Korçë është konstatuar shitblerja e votave dhe shkeljet e tjera flagrante. Ndërtimi i një skeme kriminale, e shtrirë në të gjithë Qarkun e Korçës për blerjen e votës, nëpërmjet përfshirjes të personave me rekorde kriminale (9 prova), përbën shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor, duke cënuar rëndë procesin zgjedhor, e për rrjedhojë duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Ky ndikim ka bërë të mundur dhe ndarjen jo të drejtë të mandateve për Qarkun e Korçës ku diferenca ndërmjet PS dhe LSI për mandatin e deputetit është vetëm 1598 vota, ndërsa diferenca midis subjektit zgjedhor PD-AN dhe subjektit PS ka qenë vetëm 1678 vota.
- Shitblerja e votës është një ndër problematikat kryesore të konstatuara edhe në Deklaratën e Gjetjeve dhe Rekomandimeve Paraprake të OSBE/ODIHR. Partia Demokratike nëpërmjet strukturave të saj në terren ka evidentuar dhe faktuar raste të shumta flagrante të shitblerjes së votës. Për të gjitha këto raste, PD ka depozituar 50 kallëzime penale në SPAK, ndër të cilat 30 kanë të bëjnë me raste masive të shitblerjes së votës dhe 130 kallëzime në

prokuroritë e rretheve për shkelje të tjera. Në rastin e qarkut Korçë, Partia Demokratike ka depozituar tre kallëzime në SPAK për rreth 6 zyrtarë të lartë të pushtetit qendror dhe vendor, persona me rekorde të tmerrshme kriminale, persona nën kërkim, të përfshirë drejtpërdrejtë në blerjen e votave në favor të PS. Këta persona me rekorde kriminale, drejtohen nga drejtues të lartë të institucioneve shtetërore apo drejtuesit politik të Partisë Socialiste në këtë qark.

-Veprime këto të ndaluara nga neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe neni 3 i Vendimit Nr. 9/2020 të KQZ-së.

- Blerja e votës nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera: Shitblerja e votës u krye nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera të cilat përbënin problem në procesin zgjedhor duke devijuar vullnetin e qytetarëve. Qeveria nëpërmjet akteve nënligjore ka miratuar Vendime Qeverie nëpërmjet të cilave është mundësuar dhënien e një shpërblimi në fundvit, për mjekët dhe punonjësit e Policisë së Shtetit. Është vendosur të ndryshohet struktura dhe niveli i pagave për punonjësit e stafit mjekësor, punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe punonjësit e stafit teknik të shkencave mjekësore në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë, Njësisë Mjekësore Ushtarake në Spitalin Universitar të Traumës, në strukturat e Forcave të Armatosura dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

- Këshilli Bashkiak i Bashkisë Korçë ka miratuar vendimin nr. 30, datë 25.03.2021 “Për miratimin e diferencës së kontributit financiar të Bashkisë Korçë, për vitin 2021 “Për projektin për përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetin e varfër dhe të pafavorizuar”, vendim i cili në thelb transferon një shumë prej 243,203 lekë nga programi i Arsimit bazë dhe parashkollor në programin e strehimit social.

- Kanë konstatuar dhënie e pagave shtese nga drejtuesi politik të PS për Qarkun Korçë dhe njëkohësisht Drejtor i Përgjithshëm i OSHEE, ka dhënë një pagë shpërblim për 13 mijë punonjës të OSHEE, etj.

- Nga ana tjetër, nxjerrja e akteve për dhënien e përfitimeve, bonuseve apo shpërblimeve për kategori të caktuara shoqërore përbën gjithashtu një formë të manipulimit të vullnetit të zgjedhësve nëpërmjet dhënies së të mirave materiale, çka është gjithashtu rreptësishtë e ndaluar nga nenet 78 dhe 91 të Kodit Zgjedhor.

- Shpeshherë praktika e shitblerjes së votës është e shoqëruar edhe me veprimtari të tjera të paligjshme, të tilla si marrja e dokumentit të identifikimit për të mos lejuar votimin, kanosja e zgjedhësit apo detyrimi për të votuar në një mënyrë të caktuar nga një person që ushtron një funksion publik, etj.

- Investimet publike/rindërtimi: Shteti ka vendosur investimet publike në funksion të PS-së për zgjedhjet e 25 Prill 2021. Neni 3 i Vendimit Nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së, ndalon mbështetjen dhe promovimin, në periudhën 4-mujore para datës së zgjedhjeve, të projekteve ose investimeve, me interes apo

- shtrirje territorial kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interesit të publikut. Janë evidentuar së paku 20 raste në të gjithë vendin, disa prej të cilave në Qarkun e Korçës, ku ministrat, deputetët apo kryetarët e bashkive promovuan projekte apo investime publike me qëllime të qarta elektorale. Rekordin në këtë drejtim e mban Kryetari i Bashkisë Maliq, i cili në kundërshtim të plotë me ligjin ka mbështetur dhe promovuar të paktën 5 raste. Gjithashtu nëpërmjet rrjeteve sociale janë publikuar një sërë projektesh, përmes të cilit drejtues të lartë politik të Partisë Socialiste në këtë qark, promovon faktin se është siguruar mbështetje financiare për ndërtimin e segmentit rrugor Qafa e Martës — Backë, e cila do të mundësojë lidhjen e Qarkut të Korçës me atë të Beratit.
- Intimidimi i administratës shtetërore për të mbështetur PS: Gjatë fushatës u konstatuan raste të shumta të cilat janë denoncuar vazhdimisht nga PD, sesi të gjitha nivelet e administratës vendore dhe qendrore ishin përfshirë në fushatë duke mbështetur publikisht kandidatët e PS-së. Nëpunësit civilë ishin nën presion të vazhdueshëm për të mbështetur kandidatët socialistë, në të kundërt mund të shkarkoheshin nga detyra.
  - Veç kësaj punësimi në sektorin publik u rrit ndjeshëm në periudhën parazgjedhore. Sipas INSTAT në 2020 punësimi në sektorin publik u rrit me 6% pra me 10.572 persona. Ndërkohë, më 24 Dhjetor, qeveria autorizoi edhe krijimin e 2.472 pozicione të reja në administratën publike. Qartësisht, punësimet në administratën publike në periudhën zgjedhore, kur nuk diktohen nga nevoja të ngutshme, kanë për qëllim të përkthehen në mbështetje dhe vota për partinë në pushtet. Subjekti Zgjedhor PD –AN në argumentet e saj i është referuar dhe statistikave të publikuar nga Ministria e Financës.
  - Këshilli Bashkiak i Bashkisë Korçë, ka miratuar në muajin Shkurt 2021 numrin e vendeve të reja të punës që do të hapeshin në shërbimin civil në Bashkinë e Korçës, e cila është edhe më e madhja e Qarkut. Është e qartë se kjo shtesë punonjësish është bërë në kuadër të fushatës zgjedhore, duke synuar shtimin e numrit të mbështetësve dhe votave për PS-në, në këmbim të vendit të punës.
  - Partia Shtet vendosi që të gjitha mekanizmat që dispononte t'i përdorte kundër PD-AN dhe opozitës, në mënyrë që të intimidonte jo vetëm kandidatët e PD-AN, por edhe mbështetësit e kësaj të fundit ose edhe qytetarët e thjeshtë. Kështu, më datë 18.02.2021, për motive politike, drejtuesi politik i PD në Qarkun e Korçës, është gjobitur me 5 milionë lekë ose 41 mijë euro, për një aktivitet të zhvilluar në fshatin Menkulas, ky qëndrim nuk është mbajtur i njëjtë për aktivitete të të njëjtit lloj dhe me përmasa më të mëdha ndaj kandidatëve të Partisë Socialiste.
  - Këto veprime janë shkelje të rënda ligjore, të cilat kanë si qëllim përfitim politik duke devijuar vullnetin e votuesve. Konstatimet e

sipërcituara janë evidentuar edhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR.

- Dhënia e lejeve të legalizimit/ndërtimit gjatë fushatës zgjedhore: Deputetë të ndryshëm të Partisë Socialiste kanë shpërndarë leje legalizimi në kundërshtim me përcaktimin e Kodit Zgjedhor dhe Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së. Kjo kategori, nuk e ka në kompetencë të shpërndajnë një dokument të tillë nga zyra e ASHK-së. Këto veprime qartazi tregojnë se si Partia Socialiste e ka vendosur shtetin në dispozicion të qëllimeve të saj elektorale. Në raste të përsëritura, për të cilat Partia Demokratike disponon foto dhe video, ku kandidatë për deputetë shpërndanë leje legalizimi në periudhën e ndaluar nga Kodi Zgjedhor, me qëllim të pastër elektorat. Janë evidentuar 9 raste të deputetëve të cilët kanë shpërndarë leje legalizimi me qëllim të qartë elektorat.
- Në 20 Prill, u publikua një audio përgjim i drejtorit të përgjithshëm të Kadastrës, gjatë një takimi me vartësit e tij, ky i fundit u kërkon *“...që mos procedojnë më tej me rreth 100.000 kërkesa për leje legalizimi të banesave private, të cilat me siguri do të refuzohen duke sjellë prishjen e tyre. Kjo pasi, refuzimi i dhënies së lejeve të legalizimit do të sillte që këta persona të votonin për opozitën.”*. Në të kundërt, drejtori I AKSH kërkon që të përshpejtohet procedura për rreth 60.000 kërkesa për leje legalizimi, të cilat kanë mundësi të mëdha për t'u miratuar në mënyrë që kjo të përkthehej në mbështetje për Partinë Socialiste
- Sa më lart, paditësi PD –AN, konkludon se, është e qartë se parimi i barazisë ndërmjet palëve garuese në zgjedhje u cënua rëndë pasi Shteti dhe Partia në pushtet (PS) u shkrinë në një. Një konstatim i tillë gjendet dhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR). Ky përdorim masiv i burimeve shtetërore, përveçse një veprimtari e paligjshme, e cila duhet hetuar dhe dënuar nga organet e drejtësisë, është në shkelje flagrante të neneve 78, 91, 92 të Kodit Zgjedhor dhe neneve 3 dhe 6 të Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së, çka ka cënua rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në vullnetin e zgjedhësve, rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve dhe ndarjen e mandateve në Qarkun e Korçës.
- Përdorimi i paligjshëm i të dhënave personale: Shteti vendosi të dhënat personal në dispozicion të serverave të PS në Tiranë dhe Durrës. Në datën 11 prill, media publikoi një bazë të dhënash të 910.000 zgjedhësve që përdorte Partia Socialiste në Tiranë, duke bërë publike të dhëna personale si numri i ID, vendi i banimit, numri i telefonit dhe bindja politike e shprehur në zgjedhjet e kaluara dhe projeksionet për zgjedhjet e 2021. Këto të dhëna janë marrë nga të dhëna shtetërore që qytetarët i kanë vënë në dispozicion në portalin e-albania për të marrë shërbime gjatë pandemisë, apo në institucione të tjera shtetërore për të marrë shërbime nga administrata.
- Gjithashtu sipas denoncimeve të LSI, faktohet të ketë ekzistuar një database të ngjashme në Durrës, në të cilën kishte të dhënat

personale për më shumë se 350 mijë zgjedhës, me emër/mbiemër, nr. ID, nr. telefoni, vendbanimi, etj. Rrjedhja e të dhënave personale sensitive, duke përfshirë edhe preferencat politike të zgjedhësve përbën shqetësim serioz dhe i bën zgjedhësit vulnerabil. Skandali me të dhënat personale u evidentua edhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR.

- Mbledhja, përpunimi, përdorimi dhe publikimi i të dhënave personale pa pasur miratimin me shkrim të mbajtësit të të dhënave është shkelje e rëndë e nenit 35 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenit 8 të Konventës Evropiane dhe neneve 6 dhe 7 të ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Duke qenë se Shteti dhe Partia ishin të pajisur me informacion për secilin zgjedhës, përfshirë edhe bindjet e tyre politike, kjo i bëri më vulnerabël përballë pushtetit dhe më lehtësisht viktimë e presioneve apo mjeteve të tjera të kundërligjshme për të ndaluar të shprehin vullnetin e tyre lirisht, duke përdorur mekanizma të ndryshëm pengues.
- Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor: Në datën 30.07.2020, Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet ligjit 115/2020, miratoi nismën e PS-së për disa ndryshime kushtetuese të cilat në thelb sanksiononin: (i) heqjen e koalicioneve parazgjedhore; (ii) sistemin me votim preferencial për 2/3 e kandidatëve; dhe (iii) vendosjen e një pragu kombëtar. Në vijim të ndryshimeve kushtetuese, Kuvendi i Shqipërisë miratoi në datën 05.10.2020 disa ndryshime në Kodin Zgjedhor, të cilat kishin të bënin me: (i) ulja nga 3% në 1% e pragut kombëtar; (ii) renditja e kandidatëve që përfitojnë mandat ndryshon nëse kandidati ka marrë një numër votash parapëlqyese më të madh se herësi që del nga pjesëtimi i numrit të votave të subjektit me numrin e mandateve të fituara; (iii) ri-renditjen e listës fituese sipas kandidatëve që kanë fituar numër votash më të madh se herësi; dhe (iv) kryetari i partisë ka të drejtë të kandidojë deri në katër qarqe.
- Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor nga Partia Socialiste, duke shkelur marrëveshjen konsensuale me KQZ-në u evidentuan si problematika edhe nga Misioni i OSBE/ODIHR.
- Numri i madh i fletëve të votimit të pavlefshme: Numri i votave të pavlefshme ishte 83.026, ose 5% e numrit total të votuesve dhe vetëm për Qarkun e Korçë ishin 7375 vota të pavlefshme ose 5.62%, ky fakt është ndikuar nga përmbajtja e fletës së votimit me numra dhe jo me emrat e kandidatëve, duke krijuar konfuzion ditën e zgjedhjeve.
- Miratimi i një flete votimi në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga neni 98 i Kodit Zgjedhor dhe pika 27 e Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, solli një numër tejet të lart të fletëve të votimit, të cilat nëse do të ishin përkthyer në mandate mund të ndryshonin rezultatin nga 5 – 8 mandate në të gjithë Shqipërinë. Këto mandate mund të sillnin jo vetëm ndryshimin e rezultatit në qarqe të caktuara, ku diferenca ndërmjet palëve është e ngushtë, por

edhe në rang kombëtar, kur dihet se partia e parë sipas rezultateve paraprake ka vetëm katër mandate më shumë se shumica e kërkuar për formimin e qeverisë.

- Pavlefshmëria e fletëve të votimit ka ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. veçanërisht kjo për Qarkun e Korçës ku diferenca ndërmjet PS dhe subjektit zgjedhor PD-AN ka qenë vetëm 1678 vota, ose 7 herë më i vogël se numri i votave të pavlefshme.
- Diskriminimi i kandidatëve gjatë procesit zgjedhor: Ligji u lejon vetëm Kryetarëve të partive, por asnjë kandidati tjetër që të kandidojë deri në 4 zona zgjedhore, ndërkohë që kandidatët e tjerë mund të kandidojnë vetëm në një zonë, gjë që përbën shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta, ky fakt, përbën një diskriminim në të drejtën për t'u zgjedhur, në kuptim të neneve 18 dhe 45 të Kushtetutës.
- Votimi më shumë se një herë, votimi për të tretët apo votimi familjar: Një nga risitë e zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në 25 prill 2021 ishte identifikimi elektronik i zgjedhësve. Futja e këtij mekanizmi të ri në Kodin Zgjedhor ishte kërkuar me forcë nga PD dhe kishte qenë pjesë e konsensusit të arritur ndërmjet palëve për ndryshimet e Kodit Zgjedhor në Korrik 2020. Nëpërmjet identifikimit elektronik synohej të eliminohej votimi më shumë se një herë, në të njëjtën qendër votimi apo qendra të tjera, votimi për të tretët apo votimi familjar. Por, gjithsesi ajo që mbetet problematike është fakti se nga informacionet e marra në terren nga strukturat e Partisë Demokratike rezultoi se këto fenomene nuk janë shmangur.
- Nga subjekti zgjedhor PD –AN jepen detaje mbi rastet konkrete. Është konstatuar se persona të ndryshëm kanë votuar më shumë se një herë, qoftë për të tretë apo familjarë të tyre, duke shkelur kështu drejtpërdrejtë Kodin Zgjedhor. Nga ana tjetër, ekzistenca e këtij problemi u pranua edhe nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili në datën 6 maj njoftoi fillimin e procesit të kryqëzimit të dhënave për të konstatuar rastet e votimit më shumë se një herë në një qendër votimi apo qendra të ndryshme.
- Nga të dhënat e administruara nga KAS nga kryqëzimi i të dhënave të pajisjeve PEI, rezultoi se shenjat e gishtërinjve të 23 personave janë përdorur për identifikimin e 63 zgjedhësve, çka potencialisht, siç u pranua edhe nga e Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve, ekziston dyshimi i arsyeshëm se 23 personave kanë votuar për 63 votues ose të pakën 3 herë.
- Si përfundim, subjekti zgjedhor PD – AN, vlerëson se, në tërësinë e tyre këto shkelje të ligjit shqiptar dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, cënuan rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Në këto kushte, është e qartë se vendimet e marra në kundërshtim me nenin 98 të Kodit Zgjedhor dhe pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, cënuan rëndë procesin zgjedhor, duke diktuar një rezultat në shpërprthje me vullnetin e zgjedhësve, e për rrjedhojë edhe

ndarjen e mandateve, dhe për rrjedhojë në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, ky proces zgjedhor në Qarkun Korçë duhet të shpallet i pavlefshëm dhe të urdhërohet përsëritja e zgjedhjeve në këtë qark.

- Në tërësinë e tyre këto shkelje flagrante të ligjit – shitblerja e votës, përdorimi i personave me precedentë kriminalë, përdorimi i paligjshëm i administratës, vjedhja dhe përdorimi kriminal i të dhënave personale të shtetasve nga PS, përdorimi i paligjshëm, masiv dhe sistematik i parave të buxhetit të shtetit për tjetërsimin e vullnetit të qytetarëve dhe përdorimi i lejeve të legalizimit për vota – cënuan rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore Qarku Korçë. Këto shkelje dhe pasojat e tyre përmbushin kriteret e kërkuara nga nenet 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Qarkun e Korçë.
- Me qëllim garantimin e të drejtës së palës ankuese për një proces të rregullt ligjor, PD-AN parashtron kërkesat e saj për marrjen e provave pranë organeve të administratës publike, në përputhje me nenet 136 dhe 137 të Kodit Zgjedhor, dhe nenet 223 dhe 224 të Kodit të Procedurës Civile.
- Bazuar në nenin 42 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore dhe nenet 158, 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor, përfundimisht, kërkohet: *“Pranimin e padisë për shfuqizimin e vendimit nr. 93, datë 31.05.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS), për rrëzimin e kërkesës ankimore Nr. 43 të subjektit zgjedhor Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim (PD-AN). Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Korçë. Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Korçë.”*

14. Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, gjatë gjykimit pretendoi se, vendimi nr. Nr. 93, datë 31.05.2021 i KAS, është i bazuara në ligj dhe në prova dhe si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

15. Personi i Interesuar, Partia Socialiste e Shqipërisë, gjatë gjykimit, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, pretendoi se:

- Padia e ngritura kundër vendimit të KAS Nr. 93, datë 31.05.2021 është e pabazuara në ligj dhe në prova dhe duhet të rrëzohen nga Kolegji. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ka vlerësuar drejt dhe saktë të gjitha pretendimet duke interpretuar me përpikmëri ligjin zgjedhor për mbi pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre.
- Tashmë është bërë e qartë se paditësi, subjekti zgjedhor PD-AN, për të gjitha zonat zgjedhore në Republikën e Shqipërisë përdor të njëjtat pretendime mbi të njëjtat fakte ose ngjarje dhe gjithmonë me

mungesë të theksuar të argumentimit të shkeljes dhe lidhjes shkak-pasojë.

- Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e tyre dëmprurëse mbi zgjedhjet. Në këto raste dëmi mund të vijë edhe nga një shkelje e vetme, por tronditëse për zgjedhësit ose rregullshmërinë e procesit. Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen “shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor”. Shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur.
- Në interpretim të nenit 125/4 dhe 160 të Kodit Zgjedhor, në çdo rast kërkesa për pavlefshmëri duhet të përmbajë të nominuar qendrën apo qendrat e votimit për të cilat kërkohet pavlefshmëria e rezultatit zgjedhor të miratuar. Secila qendër votimi ka specifikat e veta apo shkaqe të ndryshme, të veçanta ose të përbashkëta për konstatimin e elementëve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve dhe kjo gjithmonë në varësi të bazës faktike të pretendimit të parashtruar nga paditësit. Edhe nga përmbajtja e padisë nuk rezulton që të jenë dhënë sqarime apo interpretime sipas të cilave kërkohet pavlefshmëria e rezultatit në një apo disa qendra votimi.
- Nga ana e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë janë pretenduar fakte që lidhen me shitblerjen e votës, mohim të se drejtës për të votuar, raste të votimit të shumëfishtë, raste punësimi, dhënie ndihmash etj, por asnjëherë të provuara se sa kanë ndikuar në pengimin/largimin e zgjedhësve nga votimi, në detyrimin e votuesve që të votojnë në një mënyrë të caktuar, apo tjetërsimin e votës.
- Pala paditëse, duhet të provojë qartësisht se ka pasur shkelje të ligjit, të cilat kanë ndodhur në qendrat e votimit dhe se ekziston lidhja shkakësore ndërmjet shkeljes së ligjit dhe pasojës, pra cënimit të rëndë të procesit zgjedhor.
- Në asnjë moment nuk pretendohet pavlefshmëri në një apo disa qendra votimi konkrete të qarkut të Korçës, pra nuk përcaktohet asnjë qendër votimi me shkelje konkrete ligjore. Kërkesat detyrimisht duhet të jenë të arsyetuara, specifike dhe të identifikuar qartë.
- Po ashtu ky subjekt ka pretenduar shkelje të ligjit zgjedhor që lidhen me ushtrimin e veprimtarive të ndaluara si miratimi i V.K.M apo ndryshimeve të V.K.M, por që nuk janë ankimuar asnjëherë prej tij në KQZ.
- Përcaktimi i Urdhrit nr. 219, datë 19.04.2021 i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia" si një “vendim që pengoi efektivisht 500 mijë



*emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës*”. Ky urdhër është kontestuar pa sukses në rrugë ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit nga subjekti ankues LSI. Subjekti ankues PD nuk ka shfrytëzuar mjetet ligjore për kontestimin e tij. Për këtë arsye, ligjshmëria e urdhrit nuk mund të vihet në diskutim. Efektet e një urdhri të ligjshëm nuk mund të formojnë shkelje. Pa shkelje nuk ka pavlefshmëri.

- Lidhur me pretendimin tjetër se në ditën e zgjedhjeve, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, numri i personave të infektuar me COVID-19 ishte rreth 23.000 Statistika e ofruar nuk saktëson se sa prej tyre janë qytetarë të qarkut Korçë, e as faktin se sa prej tyre kanë qenë zgjedhës.
- Një pretendim i veçantë ka lidhje me numrin anomalisht të lartë të fletëve të votimit të pavlefshme. Në zonën zgjedhore Qarku Korçë numri i këtyre votave është 7375 ose 5.62% e numrit total të votave, por ky numër nuk mund të konsiderohet anomalisht i lartë, sepse mungon baza krahasuese, fakt ky i konstatuar drejt nga KAS.
- Në tërësinë e tyre, të gjitha faktet apo ngjarjet e pretenduar prej paditësve përveçse janë të pa provueshme për kundërligjshmërinë e tyre, nuk referojnë në të paktën një qendër votimi qarkun Korçë dhe nuk parashtrohet asnjë arsyetim i detajuar sipas kërkesave të ligjit. Ky është tregues i padiskutueshëm se shkaqet e pretenduara nuk janë gjë tjetër veçse parashtrime formale pa asnjë thelb të njohur nga ligji zgjedhor.
- Edhe sikur të kishte patur shkelje ligji, këto shkelje duhet që të kenë ndodhur në qendrën e votimit dhe jo në vende të tjera, si edhe të kenë ndikuar në shpërndarjen e mandateve.
- Sipas përcaktimeve të nenit 160, pika 4 të Kodit Zgjedhor, kuptohet, se shkeljet përveçse duhet të kenë ndodhur në ambientet e qendrës së votimit, duhet që të jetë mbajtur edhe një raport nga K.Z.A.Z ose informacioni t'i jete referuar KZAZ me shkrim nga qendra e votimit.
- K.Z.A.Z në veprimtarinë e saj ligjore të gjithë informacionin e saj mbi zhvillimin e votimeve në qendrat e votimit e ka në mënyrë të shkruar dhe të komunikuar po nga këto qendra. Asnjë prej palëve paditës nuk ka pretenduar shkelje të Pjesë II, Kreu III të Kodit Zgjedhor që lidhen me përbërjen e K.Q.V-se, papajtueshmëritë me detyrën të anëtarit të K.Q.V-se, emërimin dhe shkarkimin, mbledhjet dhe vendimet e K.Q.V-se etj.
- Kodi Zgjedhor ka përpunuar mjete ligjore të ndryshme për shkelje të ndryshme. Për një pjesë prej tyre mjete ligjor është gjoba administrative, masat disiplinore, ndjekja penale, etj, por për asnjërën prej tyre Kodi nuk ka përcaktuar si mjet ligjor pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Kjo është arsyeja pse ekzistenca e një apo më shumë shkeljeve, qofshin këto edhe të rënda, nuk është shkak i vetëmjaftueshëm për të kërkuar pavlefshmëri.

- Për sa kohë, në asnjë moment nuk provohet sipas ligjit pavlefshmëria e zgjedhjeve në një apo disa qendra e votimi, edhe kërkimi tjetër për përsëritjen e tyre sipas nenit 161 të K.Z mbetet i pa bazuar në ligj dhe në prova.
- Si përfundim, kërkohet rrëzimi i padisë si i pabazuar në ligj dhe në prova.

### III. LIGJI I ZBATUESHËM:

16. Neni 2(20) i Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë parashikon se:

*“Subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e 3 propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod.”*

17. Neni 160 i Kodit Zgjedhor titullohet “Pavlefshmëria e zgjedhjeve në qendrën e votimit” dhe parashikon se:

*“1. KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi, në rast se:*

*a) kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;*

*b) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose*

*c) votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se pesë orë.*

*2. Subjektet zgjedhore, në përputhje me rregullat dhe afatin e përcaktuar në nenin 124 të këtij Kodi, kanë të drejtë të kërkojnë në KQZ shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi.*

*3. Kërkesa për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të përmbajë shkaqet ligjore përshkrimin e rasteve të shkeljeve dhe arsyetimin e detajuar për pasojën e tyre.*

*4. Shqyrtimi i kërkesave bëhet sipas procedurave të përcaktuara në pjesën X të këtij Kodi. KQZ-ja, në marrjen e vendimit për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, mund konsultohet me KZAZ-në përkatëse. Në arsyetimin e vendimit të KQZ-së duhet të përshkruhet shkaku ligjor, rastet e vërtetuara të shkeljeve dhe arsyetimi i detajuar për pasojën e tyre.”*

18. Neni 161 i Kodit Zgjedhor titullohet “Përsëritja e zgjedhjeve” dhe parashikon se:

*“1. Pas përfundimit të procesit të ankimit, jo më vonë se 3 ditë nga nxjerrja e rezultatit të zonës zgjedhore, KQZ-ja kryesisht ose me kërkesë të subjektit, shpall të pavlefshme dhe urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore, kur pavlefshmëria e shpallur në një ose disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi, ndikon në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore ose në shkallë vendi.*

*2. Do të konsiderohet ndikim në ndarjen e mandateve për zgjedhjet në Kuvend kur numri i zgjedhëse, që kanë votuar apo mund të kishin votuar*

në qendrën apo qendrat e votimit të shpallura të pavlefshme, është i barabartë ose më i madh se numri i zgjedhësve të nevojshëm për caktimin e një mandati në zonën zgjedhore përkatëse, mbi bazën e përlllogaritjes së votave të vlefshme në zonën zgjedhore, të bërë sipas nenit 162 të këtij Kodi. Për zgjedhjet për kryetar të qeverisjes vendore ndikim në rezultat do të konsiderohet kur numri i zgjedhësve në qendrat e shpallura të pavlefshme është më i madh se diferenca midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme.

3. Në rast pavlefshmërie për shkak të fatkeqësisë natyrore, sipas shkronjës “b”, apo 85 të mosfillimit të votimit ose pezullimit më shumë se pesë orë të tij, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 160, merret në konsideratë numri total i zgjedhësve të regjistruar në qendrën e votimit të shpallur të pavlefshme.

4. Në rast pavlefshmërie për shkelje të ligjit, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 160, apo kur votimi është shpallur i pavlefshëm, sipas paragrafit të dytë të pikës 4 të nenit 138 të këtij Kodi dhe kur procesi i votimit ka përfunduar, sipas këtij Kodi, për përcaktimin e ndikimit merret në konsideratë numri i zgjedhësve që kanë votuar në qendrën e votimit të shpallur të pavlefshme.

5. Përsëritja e zgjedhjeve urdhërohet në të njëjtin vendim të KQZ-së, që i shpall ato të pavlefshme. Zgjedhjet për këshillat e qeverisjes vendore nuk përsëriten.

6. Zgjedhjet e shpallura të pavlefshme dhe për të cilat KQZ-ja ka vendosur përsëritjen, sipas këtij neni, përsëriten në një ditë të vetme për të gjitha zonat zgjedhore ku është vendosur përsëritja e tyre. Vendimi për caktimin e datës për përsëritjen e zgjedhjeve merret nga KQZ-ja me përfundimin e procedurave ankimore, sipas kësaj pjese ose me kalimin e afateve ligjore të ankimit, të përcaktuara në këtë pjesë. Përsëritja e zgjedhjeve zhvillohet jo më vonë se 4 javë nga data e vendimit.

7. Ankimi ndaj vendimit të KQZ-së për shpalljen ose jo të zgjedhjeve të pavlefshme bëhet në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në këtë pjesë”

19. Neni 136 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

“1. Në përfundim të veprimeve të përcaktuara në nenin 135 të këtij Kodi, KQZ-ja fton palët të paraqesin pretendimet e tyre dhe:

a) të japin shpjegime rreth kërkesave të parashtruara në ankim;

b) të tregojnë faktet dhe provat, mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre. Llojet e provave përcaktohen në Kodin e Procedurës Civile; dhe

c) të kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre, duke paraqitur njëkohësisht edhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur sigurimi i tyre.

2. Pas paraqitjes së pretendimeve të palëve, KQZ-ja, me kërkesë të secilës prej tyre ose kryesisht, mund të vendosë marrjen e provave të tjera kur çmon se marrja e tyre është në dobi të gjykimit.

3. Kërkesa për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, kur mbështetet nga dy anëtarë të KQZ-së dhe kur këto prova

administrohen vetëm nga KQZ-ja, pranohet menjëherë pa iu nënshtruar debatit ose votimit në KQZ. KQZ-ja është e detyruar të procedojë menjëherë me marrjen dhe shqyrtimin e provave të kërkuara.

4. KQZ-ja mund të refuzojë kërkesën e ankuesit apo të palës së interesuar për marrjen e provave, sipas shkronjës "c" të pikës 1 dhe pikës 2 të këtij neni, vetëm nëse vlerëson se prova nuk shërben për të vërtetuar faktet e pretenduara. Arsyetimi i KQZ-së për refuzimin e marrjes së provës jepet i detajuar në vendimin përfundimtar. KQZ-ja nuk mund të refuzojë kërkesën për prova, të bërë sipas pikës 3 të këtij neni.

5. Paraqitja e pretendimeve të palëve fillon me ankuesin dhe vijon me palët e interesuara, sipas radhës së caktuar nga Kryetari i KQZ-së. Kjo radhë ruhet gjatë gjithë procedimit.

6. Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në këtë nen, kur KQZ-ja çmon se një fakt, rrethanë ose ngjarje ka ndodhur, ajo merret si provë, pavarësisht nëse nuk është pasqyruar në ndonjë dokument zgjedhor."

20. Neni 223 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se:

"Gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, mund të urdhërojë palën tjetër ose një person të tretë që nuk merr pjesë në çështje, të paraqesë në gjykim një dokument ose një send tjetër, kur çmohet e nevojshme prej saj.

Në këtë rast gjykata jep udhëzimet e nevojshme për kohën, vendin dhe mënyrën e paraqitjes së tyre. Pala që ka kërkuar marrjen e dokumentit është e detyruar të tregojë me hollësi të gjitha rrethanat që bëjnë të besueshme se ku ndodhet dokumenti, karakteristikat e tij, si dhe faktet që do të provohen me këtë dokument.

Shpenzimet e nevojshme parapaguhen nga pala që ka bërë kërkesën"

21. Neni 224 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se:

"Gjykata mund të kërkojë zyrtarisht nga organet e administratës shtetërore të dhëna me shkrim për akte dhe dokumente që ndodhen në atë organ dhe që është e nevojshme të shqyrtohen në procesin gjyqësor. Kur të dhënat e kërkuara përbëjnë sekret shtetëror, gjykata kërkon lejen e organit qendror nga i cili varet administrata shtetërore ku ndodhen të dhënat e kërkuara. Kur kërkesa refuzohet, kërkesa e palës quhet si e paparashtruar."

#### IV. VLERËSIMI I KOLEGJIT ZGJEDHOR GJYQËSOR:

22. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se paditë e paraqitura nga paditësit partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-AN) janë të pabazuar në ligj e në prova dhe për këtë shkak duhen rrëzuar.

23. Paditësi PD-AN kërkoi marrjen e provave shtesë nga institucione të ndryshme shtetërore, si Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Bashkitë, Inspektoratit Qendror, etj, në lidhje me prova të mundshme, që siç u shpreh vetë kërkuesi mundet ose jo të provojnë pretendimet e kësaj pale në gjykatë. Në lidhje me këtë kërkim, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor nuk e pranoi atë me arsyetimin se nuk është mjaftueshmërisht konkret për

nevojat e këtij gjykimi. Kjo do të thotë, se kërkuesi PD-AN, kishte barrën të provonte ekzistencën e dokumenteve të ndryshme shkresore apo të dhënave që kërkonte të merreshin, ku ndodheshin konkretisht ato dhe si do të ishin të dobishme për gjykimin e çështjes. Paditësi, referuar shkaqeve të ankimit, nuk e tejkaloi barrën e të pretenduarit dhe të provuarit të kërkimit të tij për marrjen e provave, çka bëri që Kolegji të vlerësojë se ky është një kërkim i padobishëm për gjykimin dhe që cenon pa shkak të ligjshëm aftësinë e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor që të përfundojë shqyrtimin e çështjes brenda 10 ditëve, siç parashikon neni 157(1) i Kodit Zgjedhor. Pretendimet e paditësit PD-AN kishin karakter të përgjithshëm, hamendësues e hipotetik, në lidhje me situata të pretenduara prej tyre se mund të kenë ndikuar ose jo në vlefshmërinë e zgjedhjeve të 25 prillit 2021. Kaq është e pamjaftueshme, që gjykata të krijojë bindjen se marrja e provave të kërkuara nga paditësi, ishte e nevojshme për gjykimin. Qëllimi i institutit të “marrjes së provës tek të tretët” nuk është që t’i krijohet mundësia palës të hulumtojë në të dhënat e institucioneve të ndryshme shtetërore, për të gjetur ose jo, fakte apo rrethana që i shkojnë për shtat pretendimeve të veta. Paditësi duhet të sjellë prova, dëshmi (*qoftë edhe në formën e deklaratave noteriale, nën betim*) të shtetasve të ndryshëm që, nën përgjegjësinë e tyre dhe me dijeninë që kanë, identifikojnë të dhëna specifike, që janë në dobi të gjykit, e që justifikojnë më pas marrjen e provave të tjera të domosdoshme tek të tretët. Asnjë provë apo pretendim *in abstracto* nuk mund të bëhet pjesë e hetimit gjyqësor e nuk mund të shtyjë Kolegjin që të pranojë kërkesën e palës për marrjen e provave të tjera të tilla, duke e futur gjykimin në një rrugë pa krye në aspektin e nevojave të hetimit gjyqësor dhe në aspektin e afateve të vendosura nga Kodi Zgjedhor për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve zgjedhore.

24. Në rastin konkret, paditësi PD-AN ka paraqitur si provë disa kërkesa të datës 15.05.2021 drejtuar institucioneve të ndryshme shtetërore si Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Agjencisë së Prokurimit Publik, Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, INSTAT-it, Këshillit Kombëtar të Territorit, Departamenti i Administratës Publike, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Prokurorit të Përgjithshëm, Shërbimit Informativ Kombëtar, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, porse asnjë nga këto kërkesa nuk identifikon ndonjë të dhënë në lidhje me Qarkun Korçë, për të cilin zhvillohet ky gjykim. Kërkesat në fjalë kanë një natyrë të përgjithshme hetimore, ku kërkohen ndër të tjera statistika, por edhe të dhëna personale të shtetasve (*p.sh: hyrje-daljet në kufi të personave individualë*), apo të dhëna të hetimeve penale në vijim e sipër, të cilat gjithashtu krijuan bindjen tek Kolegji Zgjedhor Gjyqësor se kërkesa e paditësit për prova të tjera, ishte jo mjaftueshmërisht konkrete për nevojat e hetimit specifik gjyqësor për padinë që lidhej me zgjedhjet në zonën e Korçës.

25. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se sa i përket pretendimeve të themelit të paditësve LSI dhe PD-AN, do t'i trajtojë në vijim ato, duke i grupuar bashkë pretendimet e njëjta të palëve, si p.sh: ai që rrjedh nga urdhri i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 219, datë: 19.04.2021 për vendosjen e karantinës dy javore për shtetasit që hyjnë në Shqipëri nga Republika e Greqisë dhe Republika e Maqedonisë së Veriut.

26. Në lidhje me pretendimin e LSI dhe PD-AN se urdhri i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 219, datë: 19.04.2021 për vendosjen e karantinës dy javore për shtetasit që hyjnë në Shqipëri nga Republika e Greqisë dhe Republika e Maqedonisë së Veriut, ka passjellë mohim të së drejtës për të votuar në bllok për rreth 500.000 mijë votues shqiptarë që jetojnë në këto vende, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se ky është i pabazuar. Edhe në aspektin formal, urdhri në fjalë nuk ka dalë në kushtet e ndonjë fatkeqësie natyrore siç parashikon neni 160(1)(b) i Kodit Zgjedhor, ndaj për këtë shkak kjo referencë e paditësve nuk qëndron, e nuk mund të përbëjë shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Kjo pasi, VKM nr. 243, datë: 24.03.2020 “Për Shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore”, e dalë në bazë e për zbatim të ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, kishte afat të përcaktuar sipas nenit 18 të këtij ligji. Gjendja e fatkeqësisë natyrore është zgjatur deri më datë 23.06.2020 me vendimin nr. 18/2020 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për Dhënien e Pëlqimit për Zgjatjen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore”. Urdhri i Ministres së Shëndetësisë nr.219, datë: 19.04.2021 ka dalë në bazë e për zbatim të ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” dhe ka pasur si qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga qarkullimi i dendur i njerëzve me rastin e pashkëve ortodokse. Kufizimi i lirisë së lëvizjes nëpërmjet karantinimit dy javor ka pasur qëllimin e parandalimit të shtimit të infeksioneve COVID 19 dhe jo pengimin e emigrantëve që të ushtrojnë të drejtën e votës në Shqipëri. Ky është një efekt anësor që nuk llogaritet dot se sa njerëz ka prekur potencialisht dhe sa mund të ketë ndikuar kjo në zgjedhje në dëm të paditësve.

27. Pretendimet e paditësve janë hamendësime të pabaza në lidhje me faktin e mësipërm, pasi ata veç prezumojnë për një të drejtë potenciale të emigrantëve, e cila nuk provohet se çfarë trendi praktik ka pasur në zgjedhjet pararendëse. Nuk provohet e argumentohet se sa emigrantë janë kthyer ndër vite në Shqipëri nga Maqedonia e Veriut apo Greqia, për të votuar në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë? Asnjë studim serioz nuk u paraqit nga ana e paditësve, që të nxjerrë në pah në nivel krahasimor, sa ka qenë përqindja e votimit të emigrantëve në Qarkun Korçë në zgjedhjet e mëparshme dhe sa është penguar ajo në zgjedhjet aktuale. Argumentet e LSI se i janë përgjysmuar votat apo se herë të tjera ka marrë një mandat deputeti por këtë herë nuk e mori, janë në kufijtë e spekulimit me këtë fakt, pasi kjo forcë politike rezulton të ketë pasur një ulje të njëtrajtshme pothuajse në të gjithë Shqipërinë. Nuk mund të pretendohet e nuk u provua ndonjë lidhje shkakësore

midis pretendimit të LSI dhe pasojës së ardhur. Këtu Kolegji mban parasysh se ka shumë faktorë politikë apo socialë që ndikojnë në fluktuacionin (luhatjen) e votave në procesin zgjedhor periodik në favor apo kundër subjekteve të ndryshme garuese në zgjedhje. Për Kolegjin me rëndësi kanë vetëm elementët ligjore, të cilët nuk u provuan dot nga paditësit në këtë gjykim.

28. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor thekson gjithashtu se duhet mbajtur parasysh që në zbatim të nenit 20(2)(ç) të Kodit Zgjedhor, i përkiste Komisionit Rregullator dhe Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që të merrnin masat e nevojshme për të mundësuar votimin e emigrantëve. Ndaj, nëse vërtetë janë penguar 500.000 emigrantë apo edhe më shumë që të votojnë, kjo nuk ka ndodhur siç argumentojnë paditësit (*për shkak të urdhrit të ministres së shëndetësisë*), por për shkak se KQZ nuk ka mundësuar votën e tyre në këto zgjedhje (*vota e emigrantëve*). Neni 3 i Protokollit nr. 1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, siç është interpretuar nga Gjykata Europiane të të Drejtave të Njeriut nuk vendos një detyrim pozitiv mbi vendet anëtare për të mundësuar votimin e qytetarëve që kanë vendbanim jashtë shtetit. Kufizimi i të drejtës së votës me pasjen e vendbanimit në Shqipëri, është një kufizim proporcional (*shih çështjet (Hilbe k. Liechtenstein, 1999; Doyle k. Mbretërisë së Bashkuar, 2007; Shindler k. Mbretërisë së Bashkuar, 2013, § 105)*). Ndaj asnjë pretendim abstrakt për pavlefshmëri zgjedhjesh nuk mund të pretendohet në këtë rast, për faktin se emigrantët nuk kanë votuar në zgjedhje.

29. Në çështjet Mathieu-Mohin dhe Clerfayt k. Belgjikës, 1987, § 54; Podkolzina k. Latvia, 2002, § 33; Ždanoka v. Latvia [GC], 2006, § 106), Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se për efekt të zbatimit të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNj, çdo ligj zgjedhor duhet vlerësuar në dritën e zhvillimit politik të vendeve të caktuara. Në këtë kontekst, asnjë pretendim i paditësve LSI dhe PD-AN për pavlefshmëri të zgjedhjeve për çfarëdolloj shkak që lidhet me votën e shtetasve me vendbanim jashtë shtetit, nuk mund të merret për bazë, pasi jo vetëm nuk gjen mbështetje në dispozitat respektive të Kodit Zgjedhor, por as në nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNj. Për sa kohë që KQZ dështoi (*në mënyrë bipartizane*) që të sigurojë dhe zbatojë në praktikë votën e emigrantëve, atëherë pas zgjedhjeve nuk mund të ketë asnjë pretendim të pranueshëm në këtë drejtim, që të bëjë të mendohet se zgjedhjet mund të jenë bërë të pavlefshme, sepse është penguar një sasi e papërcaktuar emigrantësh që të vijnë në Shqipëri e të votojnë ditën e zgjedhjeve.

30. Si përfundim në lidhje me këtë pretendim të përbashkët të paditësve, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se Urdhri i Ministres së Shëndetësisë nr.219, datë: 19.04.2021, ka dalë për një qëllim legjitim, nuk ka pasur në fokus të drejtën e votës së shtetasve, është nxjerrë dhe zbatuar pa diskriminim për ndonjë shtetas në lidhje me bindjet e tij politike (*ka prekur po aq votuesit potencialë të LSI e PD-AN sa edhe votuesit e PS, apo subjekteve të tjera zgjedhore*) dhe mbi të gjitha është akt ligjor në fuqi, i pa shfuqizuar nga gjykatat kompetente. Ky akt nuk

ka dalë në kushtet e një gjendje të fatkeqësisë natyrore të shpallur sipas ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, e për këtë shkak nuk gjen zbatim neni 160(1)(b) të cilit gabimisht i referohen paditësit. Për më tepër, që siç është theksuar edhe në vendime të tjera të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në raste të ngjashme, pavlefshmëria e zgjedhjeve nuk është koncept abstrakt, por konkret dhe fillon me paraqitjen e argumenteve konkrete për secilën qendër votimi të prekur nga shkaqet pavlefshmërie, e më pas mund të çojë deri në shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre sipas nenit 161 të Kodit Zgjedhor. Paditësit dështuan të identifikojnë qendra specifike votimi ku të kenë ndodhur parregullsi apo ndikime konkrete (*si rrjedhojë e “pengesës” së emigrantëve për shkak të detyrimit për vetëkarantinim*), që të hyjnë në shkaqet e parashikuara nga neni 160, për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendrën konkrete të votimit, si paradhoma e shpalljes së zgjedhjeve të pavlefshme, kur vërtetohet se këto pavlefshmëri konkrete kanë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore përkatëse apo në shkallë vendi.

31. Në lidhje me pretendimet e tjera të paditësve, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor mban parasysht se Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në çështjet Davydov dhe të tjerët k. Ruisë, 2017, § 287; Mugemangango k. Belgjikës [GC], 2020, § 72, ka theksuar se thjesht një gabim apo parregullsi në procesin zgjedhor, e veçanërisht në fazat më teknike të tij, nuk mundet, në vetvete, të nënkuptojë pandershmërinë e zgjedhjeve, nëse kanë gjetur zbatim parimet e përgjithshme të barazisë, transparencës, paanësisë dhe pavarësisë në administrimit të zgjedhjeve. Koncepti i zgjedhjeve të lira do të vihej në rrezik vetëm nëse (i) ka prova për shkelje procedurale që janë të afta të ndalojnë shfaqjen e lirë të mendimit të njerëzve, si p.sh: nëpërmjet shtrembërimit të rëndë të vullnetit të zgjedhësve, dhe (ii) kur këto pretendime nuk gjejnë shqyrtim efektiv në rang vendi. Në çështjet Namat Aliyev k. Azerbajjan, 2010, § 78; Gahramanli dhe të tjerët k. Azerbajjan, 2015, § 73; Davydov dhe të tjerët k. Ruisë, 2017, §§ 289 et seq.; Mugemangango k. Belgjikës [GC], 2020, §§ 78 et seq., Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka mbajtur qëndrimin se që të shqyrtohen nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut pretendimet për mënyrën sesi janë trajtuar problematikat zgjedhore në rang vendor, kërkuesi duhet të tregojë se pretendimet e tij ishin “serioze dhe të debatueshme”.

32. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se pretendimet e paditësve për zgjedhjet në Qarkun Korçë, janë të përgjithshme, të paargumentuara ligjërisht, të paprovuara me prova bindëse, d.m.th jo “serioze dhe të diskutueshme”. Pretendimet për “blerje vote” dhe përdorim të personave me rekorde të tmerrshme kriminale nga ana e PS, në dëm të PD-AN, mbetën në kuadrin e pretendimeve dhe nuk e kaluan këtë stad, në mënyrë që të provonin shkak konkret pavlefshmërie për qendra të caktuara votimi dhe më tej ndikimin në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore Korçë ose në shkallë vendi. Kallëzimet e PD-AN nuk mund të përbëjnë provë për sa pretendohet nga ky subjekt dhe për më tepër, edhe nëse vërtetë ka pasur ndonjë parregullsi të tillë, nuk provohet ndikimi



thelbësor në shfaqjen e lirë të vullnetit të njerëzve në zgjedhjet e 25 prillit 2021. Problematikat e evidentuara në raportin e OSBE-ODIHR, të pretenduara nga paditësi, nuk janë provë se këto problematika kanë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore Korçë ose në shkallë vendi.

33. Paditësi PD-AN pretendon se partia në pushtet ka blerë vota nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera tek qytetarët. Pretendohet se një nga këto akte është vendimi i Këshillit Bashkiak Korçë nr. 30, datë: 25.03.2021, porse nuk qartësohet se sa është realizuar ky akt në praktikë dhe a kishte mundësi të ndikonte në zgjedhjen e njerëzve. Prezumimi që kërkon të nxjerrë në pah paditësi, se çdo përfitim që shteti u jep qytetarëve, ndikon në votën e tyre, është i paargumentuar dhe i paprovuar gjyqësisht, e nuk mund të merret i mirëqenë *a priori*. Neni 91(4) i Kodit Zgjedhor parashikon se *“[k]atër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.”* Nga ana tjetër neni 160(1)(a) i Kodit Zgjedhor parashikon se pavlefshmëria e zgjedhjeve në një qendër votimi shpallet kur *“kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;”*. Paditësi ka barrën e provës të provojë se vendimi i mësipërm i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Korçë, edhe nëse merret e mirëqenë se bie ndesh me nenin 91(4) të Kodit Zgjedhor ka cenuar rëndë procesin zgjedhor. Asnjë dëshmi, apo provë tjetër nuk u paraqit nga pala paditëse në këtë drejtim. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor rithekson se jo çdo parregullsi apo taktikë e paligjshme e ndjekur në zgjedhje, ndikon domosdoshmërisht në rezultatin e zgjedhjeve, pasi zgjedhësit janë mjaftueshëmrisht të pjekur dhe të mësuar ndër vite që të dallojnë cilat veprime bëhen thjesht për fushatë e cilat janë të sinqerta.

34. Paditësi PD-AN pretendoi se shteti ka vendosur investimet publike në funksion të PS-së për zgjedhjet e 25 prillit 2021, duke disfavorizuar opozitën. Edhe ky pretendim mbeti në kuadrin e një pretendimi të përgjithshëm për ndikim ose jo në zgjedhje, e për këtë shkak nuk merret parasysh si i paprovuar bindshëm nga Kolegji. Paditësi parashitroi se ka evidentuar rreth 20 raste në rang vendi, disa prej të cilave në Korçë, ku ministrat, deputetët apo kryetarët e Bashkive promovuan projekte apo investime publike me qëllime të qarta elektorale. Edhe ky argument, përveçse pa ndonjë ndikim të provuar në qarkun Korçë, vlerësohet nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor se nuk ka ndikuar në mënyrë të rëndësishme

në zgjedhje, aq më tepër kur zgjedhësit në Shqipëri nuk e hasin për herë të parë këtë qasje të pushtetarëve.

35. Padiësi pretendon se PS ka intimiduar administratën shtetërore gjatë fushatës dhe se vetë PD ka denoncuar shumë raste të tilla. Edhe në lidhje me këtë, Kolegji rithekson se shkeljet individuale të denoncuar nga PD, përveçse mbeten në kuadrin e pretendimit të një pale, nuk provohet se kanë qenë të tilla që të kenë ndikuar dukshëm në rezultatin e zgjedhjeve. Argumentet e padiësit në lidhje me të dhënat e marra nga INSTAT janë krejtësisht të përgjithshme dhe jo konkrete për qarkun Korçë. Pretendohet gjithashtu se janë bërë punësime në administratën publike gjatë periudhës 4 mujore para datës së zgjedhjeve, porse nuk provohet ndonjë ndikim të zgjedhjeve. Kolegji rithekson se barra e të provuarit në lidhje me këto pretendime, qoftë me dëshmi apo me çdo lloj tjetër prove bindëse, bie mbi palën padiëse, e cila dështoi në këtë drejtim. Këto pretendime të padiësit mbeten në planin subjektiv, pa u konkretizuar me të dhëna konkrete që të nxjerrin qartazi në pah ndikimin e ndjeshëm në rezultatin e zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi, siç kërkon neni 160 i Kodit Zgjedhor.

36. Padiësi pretendon se janë shpërndarë në mënyrë të paligjshme leje legalizimi, porse edhe në këtë rast nuk është në gjendje të identifikojë ndonjë rast konkret në Korçë, që të ketë ndikuar në mënyrë të rëndësishme në zgjedhjet e zhvilluara në ndonjë qendër të veçantë votimi. Pretendime të tilla të përgjithshme, janë thjesht të pamjaftueshme për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në Korçë.

37. PD-AN ka pretenduar se “skandali i patronazhistëve” ka ndikuar në zgjedhje, porse nuk argumenton se si ka qenë e mundur një gjë e tillë. Ky pretendim është aq i përgjithshëm në raport me cenimin e zgjedhjeve, sa nuk mund të përbëjë argument në favor të pavlefshmërisë së zgjedhjeve. I takon organeve kompetente të vlerësojnë rëndësinë e faktit dhe të vënë para përgjegjësisë këdo që mund të ketë shkelur ligjin, porse për efekt të këtij gjykimi, rëndësi kanë argumentet që lidhen me cenimin e rëndë të zgjedhjeve dhe jo çdo ndodhi e para datës 25 prill 2021, e cila nuk provohet se ka impakt negativ në zgjedhje.

38. Më tej padiësi PD-AN ngre si pretendim të cenimit të zgjedhjeve nga PS dhe të humbjes së vet në zgjedhje edhe ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor. Kjo është një çështje jashtë kompetencës së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, por eventualisht padiësi duhet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e çdo ligji që mendon se bie ndesh me Kushtetutën. Detyra e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor është ta zbatojë Kodin Zgjedhor ashtu siç e ka draftuar ligjvënësi, e jo ta vërë atë në diskutim. Megjithatë Kolegji Zgjedhor Gjyqësor sjell në vëmendje edhe Opinioni i Venecias nr. 1006/2020, datë 11.12.2020, i dhënë pas kërkesës së Presidencës së Republikës së Shqipërisë, lidhur me ndryshimet kushtetuese dhe ligjore, të evidentuara nga padiësi. Ndërsa kritikohet shpejtësia me të cilën ligjvënësi i kreu këto ndryshime, lidhur me thelbin e tyre, Komisioni jep opinionin se:

“38. Sipas Kodit të Praktikës së Mirë në Çështje Zgjedhore, “[m]bi bazën e zbatimit të parimeve (të tjera) (të mishëruara në Kod), mund të zgjidhet çdo sistem zgjedhor”. Në rrethana të caktuara, vetë natyra e sistemit zgjedhor mund të jetë problematike në një vend të caktuar. Nuk ka asnjë element të na bëjë të gjykojmë se i tillë është rasti me sistemin zgjedhor në Shqipëri pas miratimit të ndryshimeve që po shqyrtohen, rrezja e veprimit të të cilave është relativisht e kufizuar.

39. Në veçanti, nuk ka standarde ndërkombëtare që kanë të bëjnë me zgjedhjen ndërmjet listave të mbyllura dhe të hapura dhe, nëse zgjidhen këto të fundit, shkallën dhe ndikimin e preferencave të shprehura nga votuesit. Kjo është e vërtetë gjithashtu për pranimin ose jo të koalicioneve zgjedhore për qëllime të ndarjes së vendeve (apparentements) dhe ekzistencës së një pragu mjaft të ulët në nivel rajonal (sikurse në tekstin e mëparshëm) apo në nivel vendor (siç prezantohet nga ndryshimet). ...”

39. Paditësi pretendoi se numri i lartë i fletëve të votimit të pavlefshme ka ardhur si rrjedhojë e fletës së votimit me numra e jo me emra kandidatësh. Ky pretendim është perceptim subjektiv i kësaj pale, i pambështetur në ndonjë studim serioz dhe që nuk mban parasysh se pavlefshmëria e fletëve të votimit përveçse nga ngatërresa të votuesit, mund të vijë edhe nga vullneti i tij (*pasi mund të mos ketë besim tek asnjë prej alternativave që i ofrohen për të zgjedhur*). Për më tepër që Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka argumentuar në detaje vendimin e vet për fletën e votimit që u përdor në zgjedhjet e 25 prillit 2021, të cilat edhe mund të mos zhvilloheshin dot, duke e futur vendin në një skenar të paprecedentë, nëse nuk do të merrej ai vendim nga Kolegji Zgjedhor.

40. Paditësi pretendon si shkak shtesë për pavlefshmërinë e zgjedhjeve faktin se kandidatët janë diskriminuar pasi kryetarëve të partive u lejohej kandidimi deri në 4 zona zgjedhore, ndërsa të tjerëve jo. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor rithekson se sipas praktikës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, pretendimet për parregullsi sipas nenit 3 të protokollit nr. 1 të KEDNj, duhet të jenë serioze dhe ky pretendim nuk e kalon këtë test. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor nuk është gjyqtar i Kodit Zgjedhor, pasi këtë e miraton Kuvendi, por nëse paditësi ka kundërshtime për sa më sipër, mund t'i adresojë shqetësimet e veta pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, që është forumi i përshtatshëm për këtë gjë.

41. U pretendua gjithashtu se në zgjedhjet e 25 prillit 2021 kanë ndodhur fenomenet e votimit familjar apo më shumë se një herë. Ky pretendim është gjithashtu i pabazë, pasi siç ka dëshmuar edhe nënkomisionerja e zgjedhjeve, rastet e identifikimit elektronik të shumfishtë janë më së shumti raste kur makineria nuk ka lexuar si duhet shenjën e gishtit të personave dhe për këtë qëllim është vënë shenja e gishtit më shumë se një herë nga votuesi apo persona të komisionit. Asnjë e dhënë konkrete serioze nuk u provua për Qarkun

Korçë, ndaj edhe ky argument nuk mund të merret për bazë nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor. Por edhe nëse do të merret i mirëqenë fakti i mësipërm, shifrat janë aq të papërfillshme sa nuk kanë asnjë ndikim në rezultatin final të zgjedhjeve.

42. Siç ka theksuar edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në vendimin e saj në çështjen Kovach v. Ukraine, 2008, vendimi për të bërë zgjedhjet të pavlefshme duhet të reflektojë një paaftësi të vërtetë për të përcaktuar dëshirat e zgjedhësve. Në rastin konkret objekt gjykimi vullneti i zgjedhësve ka qenë i qartë dhe pa mëdyshje. Asnjë nga komisionerët e qendrave të votimit, anëtarët e grupeve të numërimit të votave apo komisionerët pranë KZAZ-ve (*të cilët për zgjidheshin nga PS, PD e LSI*), nuk ka kontestuar vlefshmërinë e votave apo zgjedhjeve në qendra të veçanta votimi, e në këto kushte, në zbatim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor nuk ka një bazë të arsyeshme për të shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve, të cilat ndonëse jo të përkryera, vlerësohet se nuk janë prekur nga vese të tilla që të pamundësojnë leximin e qartë të vullnetit të votuesve. Asnjë shkelje e rëndë nuk u provua në këtë gjykim, që të zhbëjë zgjedhjet në Korçë, ndaj për këtë shkak të dy paditë duhet të rrëzohen si të pambështetura në prova e në ligj.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenet 158, 159 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

### **V E N D O S I :**

1. Rrëzimin e padive të palëve paditëse Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD-AN), si të pambështetura në prova dhe në ligj.
2. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
3. U shpall sot në Tiranë, më datë 10 qershor 2021.

**ANËTAR**

**Sokol IBI**

**ANËTARE**

**Edlira PETRI**

**KRYESUES**

**Asim VOKSHI**

**ANËTARE**

**Esmeralda XHILI (ÇEKA)**

**ANËTARE**

**Alma KOLGJOKA**